

**Arbër HADRI**

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: arberhadri@outlook.com

ORCID: 0009-0000-5235-2962

KUD: 327(73):355.4(496.51)“1999”(05)

**DIPLOMACIA AMERIKANE GJATË BOMBARDIMEVE  
NË KOSOVË: STRATEGJIA, SIGURIA DHE  
MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE****Abstrakt:**

*Ky studim shqyrton rolin e diplomacisë amerikane dhe ndërhyrjes së NATO-s gjatë luftës në Kosovë në vitin 1999, me theks të veçantë në strategjitë diplomatike dhe ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ndikimin e tyre në zhvillimet politike, humanitare dhe rajonale. Konteksti historik lidhet me intensifikimin e dhunës nga forcat serbe ndaj popullit shqiptar në Kosovë dhe nisjen e bombardimeve të NATO-s në mars të vitit 1999. Analiza fokusohet në qëndrimin e SHBA-së dhe veprimet e saj diplomatike, veçanërisht në veprimtarinë diplomatike të Përfaqësuesit Special Richard Holbrooke, si dhe vlerëson mënyrat se si administrata amerikane menaxhoi presionin mbi regjimin e Slobodan Millosheviqit, ruajti kohezionin brenda Aleancës transatlantike dhe trajtoi sfidat e sigurisë rajonale. Argumenti kryesor i punimit konsiston në shqyrtimin e mënyrës se si diplomacia shtrënguese amerikane, e kombinuar me presionin ushtarak të NATO-s, u pozicionua në raport me një zgjidhje të qëndrueshme paqësore, duke parandaluar përhapjen e dhunës dhe spastrimin etnik. Studimi trajton tri linja kryesore strategjike amerikane: angazhimin me Grupin e Kontaktit për krijimin e një fronti diplomatik të koordinuar, forcimin e bashkëpunimit me vendet rajonale për rritjen e presionit ndaj Beogradit dhe menaxhimin e marrëdhënieve me Rusinë për të shmangur pengesat diplomatike, si dhe përdorimin e bombardimeve të shenjëzuara për të detyruar ndryshimin e pozicionit serb, pa shkaktuar viktima të panevojshme. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është analiza e sjelljes së Millosheviqit dhe ndikimi i tij mbi zgjedhjet strategjike të SHBA-së dhe NATO-s, duke përfshirë opsionet e dorëzimit, vazhdimin të rezistencës ose ndryshimit të regjimit.*

*Në aspektin metodologjik, ky artikull mbështetet në analiza historiografike dhe dokumentare, duke shfrytëzuar strategjitë dhe dokumentet e Departamentit të Shtetit, memorandumet dhe raportet e Përfaqësuesit Special, dokumentet zyrtare të KSK, si dhe materialet arkivore së fundmi të deklasifikuara nga institucionet amerikane. Kjo qasje lejon identifikimin e linjave kryesore të veprimit, vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe interpretimin e ndikimeve të ndërhyrjeve diplomatike dhe ushtarake në vendimmarrje. Analiza përfshin gjithashtu perspektivën psikologjike të Millosheviqit dhe strukturave të brendshme të regjimit, duke krijuar një kuadër të plotë për të kuptuar vendimet strategjike të SHBA-së dhe Aleatëve. Studimi gjithashtu shqyrton prospektin e ndërhyrjes tokësore si mundësi të fundit, duke vlerësuar rreziqet dhe sfidat që kjo do të sillte, përfshirë pasigurinë strategjike, tensionet rajonale dhe nevojën për koordinim ndërkombëtar. Analiza vë në dukje se kombinimi i presionit ushtarak, angazhimit diplomatik, ndihmës humanitare dhe përfshirjes së strukturave ndërkombëtare ishin vendimtare për efektivitetin e strategjisë amerikane, që rezultoi me dorëzimin e Millosheviqit dhe marrjen nën kontroll ushtarak dhe civil të Kosovës. Përfundimet theksojnë se strategjia amerikane, e cila kombinonte diplomacinë intensive me ndërhyrjen ushtarake, detyroi dorëzimin e regjimit serb të Millosheviqit dhe krijoi kushtet për një marrëveshje ndërkombëtare, përfshirë Marrëveshjen e Kumanovës dhe vendimet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Si rezultat, u siguroa mbrojtja dhe rikthimi i popullit shqiptarë në shtëpitë e tyre në Kosovë, u vendos një forcë ndërkombëtare sigurie, filloi konsolidimi i Kosovës drejt përcaktimit të statusit të saj përfundimtar politik, dhe u përgatit terreni për ndryshimin e regjimit në Serbi si dhe për stabilizimin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor.*

**Fjalë kyçe:** Kosovë, diplomacia amerikane, NATO, Slobodan Millosheviq, Richard Hollbruk, Balkan, ndërhyrje ndërkombëtare.

**Abstract:**

*This study provides an in-depth analysis of American diplomacy and NATO intervention during the 1999 Kosovo war, with a particular focus on the United States' diplomatic and military strategies and their broader implications for political, humanitarian, and regional developments. The historical context is situated within the intensification of violence perpetrated by Serbian forces against the Albanian population in Kosovo, culminating in the NATO-led air campaign launched in March 1999. This*

*research examines the US position and its diplomatic efforts, highlighting the central role of Special Representative Richard Holbrooke in shaping policy, coordinating international engagement, and managing pressure on the regime of Slobodan Milošević, while ensuring cohesion within the transatlantic alliance and addressing the complex security dynamics of the region. The central argument of the study emphasizes the strategic interplay between intensive American diplomacy and targeted NATO military action as a mechanism to prevent further escalation of violence, halt ethnic cleansing, and create conditions for a sustainable political settlement. The research identifies three primary US strategic lines: coordinated engagement with the Contact Group to consolidate international diplomatic efforts; strengthened cooperation with regional actors, particularly Albania and Macedonia, to enhance pressure on Belgrade; and the careful management of relations with Russia to mitigate potential diplomatic obstacles. Military measures, particularly targeted airstrikes, were employed to compel a shift in Serbian policy while minimizing civilian casualties. The study further explores the behavior of Milošević and the internal dynamics of his regime, analyzing how these factors influenced US and NATO strategic options, including surrender, continued resistance, or potential regime change. Methodologically, this study employs historiographical and documentary analysis, utilizing Department of State strategies and records, Richard Holbrooke's memoranda and reports, official NSC documents, and recently declassified archival materials from U.S. institutions. This approach facilitates a systematic reconstruction of strategic decision-making, an evaluation of the effectiveness of diplomatic and military policies, and a nuanced interpretation of their impact on crisis management. Additionally, the research integrates a psychological and structural assessment of Milošević's regime, offering insights into the interplay between leadership behavior and the conduct of international interventions. The study also considers the prospect of a ground intervention as a last-resort option, assessing its associated risks, including strategic uncertainty, regional destabilization, and the complexities of coordinating multinational forces. Findings indicate that the combination of diplomatic engagement, humanitarian assistance, military pressure, and international institutional involvement was critical to the success of the US strategy, which resulted in Milošević's surrender and the establishment of military and civil control over Kosovo. The conclusions underscore that the American strategy, which integrated intensive diplomacy with military intervention, compelled*

*the surrender of Milošević's Serbian regime and established the conditions for an international settlement, including the Kumanovo Agreement and relevant UN Security Council resolutions. Consequently, the protection and return of the Albanian population to Kosovo were secured, an international security force was deployed, the process of consolidating Kosovo toward determining its final political status commenced, and the groundwork was laid for both regime change in Serbia and the broader stabilization of the Western Balkans.*

**Keywords:** Kosovo, American diplomacy, NATO, Slobodan Milošević, Richard Holbrooke, Balkans, international intervention.

Politika e Shteteve të Bashkuara ndaj luftës në Kosovë deri në fund të marsit 1999, ndërkohë që fushata e bombardimeve ajrore të NATO-s kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) ndodhej ende në fazën e saj fillestare dhe karakterizohej nga pasiguri strategjike, u strukturua rreth një sinteze ndërmjet presionit të vazhdueshëm ushtarak dhe intensifikimit të veprimtarisë diplomatike, të konceptuar jo për të zbutur, por për të përforcuar efektin shtrëngues të ndërhyrjes. Një dokument politik i Departamentit të Shtetit të SHBA-së, i datës 27 mars 1999 vetëm tri ditë pas fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s artikulonte një strategji diplomatike me dy orientime kryesore, duke synuar njëkohësisht ruajtjen e kohezionit të Aleancës, menaxhimin e marrëdhënieve me aktorët e jashtëm kyç, veçanërisht Federatën Ruse, si dhe konsolidimin e bashkëpunimit rajonal ndërmjet shteteve të ekspozuara drejtpërdrejt nga lufta dhe pasojat e saja politike, humanitare dhe të sigurisë. Në thelb, kjo qasje e politikës amerikane pasqyronte një aplikim të sofistikuar të diplomacisë shtrënguese, ku përdorimi i forcës ushtarake nuk perceptohej si zëvendësim i diplomacisë, por si parakusht themelor i mundësisë së zbatimit të saj, ndërsa mekanizmat institucionalë ndërkombëtarë u instrumentalizuan për të kufizuar hapësirën manovruese të kundërshtarit dhe për të siguruar përfshirjen e partnerëve, pa cenuar vrullin operacional të fushatës së bombardimeve ushtarake të SHBA-së, respektivisht NATO-s.<sup>1</sup>

Në planin strategjik, diplomacia amerikane gjatë kësaj periudhe vendimtare u artikulua nëpërmjet dy boshteve kryesore veprimi. *Boshti i parë diplomatik* synonte riaktivizimin e Grupit të Kontaktit si instrument

<sup>1</sup> *Kosovo Diplomatic Strategy*, Memorandum, Department of State, March 27, 1999, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR., USA.

i koordinimit politik ndërmjet fuqive kryesore boërore, me perspektivën e kushtëzuar të thirrjes së një takimi ministror, të varur nga përmbushja e disa parakushteve substanciale politike dhe operacionale. *Boshti i dytë diplomatik* u përqendrua në intensifikimin e angazhimit me shtetet fqinje të Kosovës, që në këtë periudhë të fushatës ushtarake të NATO-s, konsideroheshin si vende me rrezikshmëri të lartë dhe në vijën e parë të frontit në Evropën Juglindore. SHBA-të konsideronin se duhej forcuar kohezioni dhe vendosmëria e tyre politike, të reduktoheshin pikat e dobëta të këtyre shteteve, të sigurohej bashkëpunimi i qëndrueshëm i tyre me Aleancën përballë presionit serb, si dhe ballafaqimi e përkrahje me pasojat e krizës humanitare. Të marra në ndërveprim, këto dy linja strategjike diplomatike synonin të sinjalizonin se veprimi diplomatik zhvillohej paralelisht dhe në funksion të operacioneve ushtarake, duke përcaktuar qartë se diplomacia nuk do të lejohej të zëvendësonte apo të minonte logjikën detyruese që zbatohet nëpërmjet ndërhyrjes ushtarake të NATO-s.<sup>2</sup>

### **Strategjia diplomatike për Kosovën: Veprimi diplomatik në kuadër të ndërhyrjes ushtarake**

Ndërsa fushata ajrore e NATO-s vijonte pa ndërprerje, politikëbërësit amerikanë i kushtuan rëndësi të veçantë ruajtjes së një profili aktiv diplomatik, me synimin për të demonstruar se përdorimi i forcës nuk përjashtonte veprimin politik dhe diplomatik. Megjithatë, këto përpjekje diplomatike u konceptuan dhe u administruan me kufizime të rrepta strategjike. Qëndrimi i politikës së jashtme amerikane theksonte në mënyrë eksplicite se asnjë iniciativë diplomatike nuk duhej të pengonte, vononte ose të ishte në kundërshtim me ecurinë e operacioneve ushtarake, si dhe të krijonte rrethana politike që do t'i detyronin Shtetet e Bashkuara apo Aleatët e tyre të pezullonin fushatën e bombardimeve ajrore përpara arritjes së objektivave themelore strategjike. Ky pozicion reflektonte një rend hierarkik të qartë ndërmjet forcës dhe diplomacisë, në të cilin mjeti ushtarak përbënte boshtin kryesor të shtrëngimit, ndërsa diplomacia ishte e instrumentalizuar për ta përforcuar atë. Diplomacia nuk u konceptua si alternativë ndaj përdorimit të forcës, as si mekanizëm kompromisi i parakohshëm, por si një komponent funksional i strategjisë së përgjithshme shtrënguese, i orientuar drejt kanalizimit të

---

<sup>2</sup> Ibid.

presionit ndërkombëtar dhe menaxhimit të implikimeve politike pa cenuar vullin operacional të NATO-s. Në këtë kuptim, veprimi diplomatik u vendos në shërbim të logjikës së diplomacisë detyruese, duke synuar maksimalizimin e efektit politik të operacioneve ushtarake në vend që ta kufizonte ose relativizonte atë.<sup>3</sup>

Kjo qasje pasqyrore mësimeve e nxjerra nga fazat e mëparshme të luftës së Kosovës, në veçanti nga marrëveshja e tetorit 1998 e ndërmjetësuar nga Përfaqësuesi Special Richard Holbrooke (Hollbruk), e cila, ndonëse arriti të ndalë përkohësisht operacionet serbe, dështoi të rezultonte me një pajtueshmëri reale ose një zgjidhje politike të qëndrueshme. Deri në mars të vitit 1999, zyrtarët amerikanë ishin plotësisht të vetëdijshëm për rreziqet strategjike që shoqëronin pauzat diplomatike, të cilat i krijonin Beogradit hapësirë për riorganizim ushtarak, rikonsolidim politik dhe shfrytëzim të ndarjeve brenda bashkësisë ndërkombëtare. Për rrjedhojë, çdo formë e angazhimit diplomatik të ripërtërirë, cilësohej nga Washingtoni se duhej të kalibrohej me rigorozitet, në mënyrë që të funksiononte si një instrument për intensifikimin e presionit ndaj regjimit të Sllobodan Millosheviqit, dhe jo si një mekanizëm që do ta zbuste ose amortizonte efektin detyrues të operacioneve ushtarake të NATO-s.<sup>4</sup>

Brenda kuadrit të strategjisë diplomatike të SHBA-së për Kosovën, *Binari i parë diplomatik*, karakterizohej nga angazhimi formal shtet-me-shtet, me qëllim të menaxhimit të kujdesshëm dhe të kalibruar të Grupit të Kontaktit. Shtetet e Bashkuara sinjalizuan një hapje të kushtëzuar ndaj propozimit rus për thirrjen e një takimi ministror të Grupit të Kontaktit, një qëndrim që reflektonte një përllogaritje të dyfishtë strategjike, nga njëra anë Washingtoni njihnte vendosmërinë e Moskës për të ruajtur rolin e saj si Fuqi e Madhe, si dhe nga ana tjetër perceptoi vlerën potenciale të Grupit të Kontaktit si një forum për riafirmimin dhe ndërkombëtarizimin e kërkesave kyçe ndaj Beogradit. Në të njëjtën kohë, politikëbërësit amerikanë u orientuan rreth riformësimit të kushteve të angazhimit, duke siguruar që çdo aktivitet i ripërtërirë i *Shtyllës së parë diplomatike*, lidhur me Grupin e Kontaktit, nuk do të ndërhynte në operacionet e NATO-s, si dhe nuk do të dobësonte kohezionin e Aleancës.<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Hadri, Arbër. "Ultimatumi i Presidentit Bill Clinton dhe përgatitjet për intervenimin ushtarak në Kosovë: shtator–tetor 1998," *Kosova*, no. 47 (2024): 149–170.

<sup>5</sup> *Kosovo Diplomatic Strategy*, Memorandum, Department of State, March 27, 1999, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR., USA.

Si rezultat, Grupi i Kontaktit funksionoi më pak si një arenë ndërkombëtare diplomatike dhe më shumë si një instrument i një strategjie diplomatike amerikane, e orientuar për të përforcuar vendosmërinë e Aleancës, si dhe për të kanalizuar përfshirjen ruse dhe për të parandaluar çdo iniciativë që mund të kufizonte ose të dobësonte efektivitetin e luftës ajrore.

Rusia kishte propozuar thirrjen e një takimi ministror të Grupit të Kontaktit në Moskë, të kushtëzuar në mënyrë të qartë me ndalimin e bombardimeve të NATO-s. Politikëbërësit amerikanë vlerësuan se ky kusht nuk ishte i pathyeshëm dhe se në këtë kuadër interesi më i madh i Rusisë ishte që të ruante statusin e saj si aktor kyç në çështjet e sigurisë evropiane, që për rrjedhojë do të mund ta shtynte atë të pranonte një takim të Grupit të Kontaktit edhe përkundër vazhdimin të bombardimeve të NATO-s. Ky vlerësim reflektonte një kuptim të nuancuar të motiveve ruse, duke bërë dallimin midis kundërshtimit retorik ndaj veprimeve të NATO-s dhe interesave qenësor të Moskës për të mbetur e angazhuar në menaxhimin e luftës. Pas konsultimeve dypalëshe me të ashtuquajturën *Katërshja-Quad*<sup>6</sup>, Sekretarja e Shtetit Madeleine Albright, ishte e gatshme t'i përgjigjej Ministrit të Jashtëm rus Igor Ivanov, duke sinjalizuar se SHBA-ja ishte e hapur për realizimin e takimit të Grupit të Kontaktit sipas njërit prej dy skenarëve: që takimi të mbahej pa ndërprerje të fushatës së bombardimeve të NATO-s, ose që Ivanov të siguronte paraprakisht bindjen e Millosheviqit për të ndaluar ofensivën ushtarake dhe të spastrimit etnik në Kosovë, si dhe të rikthejë forcat e Ushtrisë Jugosllave dhe Ministrisë së Brendshme Serbe në kazernat e tyre.<sup>7</sup>

Kushti i dytë u konsiderua i pamundur për t'u përmbushur, duke pasur parasysh ndikimin e kufizuar që Moska ushtronte mbi Beogradin në atë fazë të luftës. Për më tepër, zyrtarët amerikanë kuptuan se edhe nëse Ivanov do të kishte mundur të siguronte një pezullim të përkohshëm të operacioneve ushtarake serbe, një rezultat i tillë mund të rezultonte me një pauzë të pacaktuar dhe pa perspektivë të besueshme për një zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë. Për të neutralizuar këtë rrezik, strategjia diplomatike e SHBA-së vendosi që çdo vendim për rifillimin e bombardimeve të mbetej ekskluzivisht brenda autoritetit të udhëheqjes ushtarake të NATO-s, konkretisht Komandantit Suprem të Forcave Aleate për Evropën (SACEUR) Gjeneralit Clark ose Sekretarit të

<sup>6</sup> The United States, United Kingdom, France, and Germany.

<sup>7</sup> *Kosovo Diplomatic Strategy*, Memorandum, Department of State, March 27, 1999, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR., USA.

Përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, duke u bazuar në vlerësimet mbi përputhshmërinë e forcave serbe me kufizimet e marrëveshjes së tetorit të vitit 1998, lidhur me prezencën e tyre jashtë garnizonit të kontrolluar. Kjo dispozitë e strategjisë amerikan u hartua për të parandaluar që manovrat diplomatike të kufizonin autonominë e veprimit ushtarak të NATO-s. Në nivel institucional, Shtetet e Bashkuara kërkuan që çdo takim ministror i Grupit të Kontaktit të paraprihej nga diskutime përgatitore në nivelin e drejtorëve politikë, përfshirë edhe drejtorët politikë të kuadrit të *Katërshes*. Kjo renditje kishte për qëllim të siguronte që një takim në nivel ministror të bazohej mbi një themel të fortë dhe të prodhonte të paktën rezultate minimale dhe thelbësore. Objektivat e pranueshme u përcaktuan qartë: riafirmimi i kornizës së Rambujesë si bazë për zgjidhjen e situatës dhe një thirrje për ndaljen e menjëhershëm të sulmeve ndaj popullsisë civile shqiptare. Duke ulur pritjet dhe duke përcaktuar qartë objektivat, politikëbërësit amerikanë synuan të minimizonin rrezikun që një takim i Grupit të Kontaktit të shfrytëzohej nga Beogradi ose Moska për të minuar unitetin e Aleancës ose për të legjitimuar kokëfortësinë serbe.<sup>8</sup>

Paralelisht me menaxhimin e vijës diplomatike përmes Grupit të Kontaktit, strategjia diplomatike e SHBA-së për Kosovën mbështetej shumë në angazhimin e *Shtyllës (Binarit) së dytë diplomatike* lidhur me shtetet fqinje të Kosovës në vijën e parë të frontit, si një mekanizëm i stabilitetit rajonal. Washingtoni i kushtoi vëmendje të vazhdueshme atyre shteteve fqinje të Kosovës, bashkëpunimi i të cilave konsiderohej i domosdoshëm për strategjinë më të gjerë të presionit kundër Millosheviqit.

Shqipëria dhe Maqedonia, në veçanti, konsideroheshin se ishin të ekspozuara ndaj kërcënimit ushtarak serb dhe përhapjes së luftës në këto vende, flukseve të refugjatëve në shkallë të gjerë, si dhe rrezikut më të gjerë të destabilizimit rajonal. Vlerësimet e politikave të SHBA-së pohuan se Millosheviqi tentonte në mënyrë aktive të shfrytëzonte këto dobësi përmes kërcënimeve detyruese të dizajnuara për të dobësuar vendosmërinë e këtyre shteteve fqinje të Kosovës, si dhe për të kufizuar bashkëpunimin e tyre me NATO-n. Në këtë kuadër, diplomacia e *Shtyllës së dytë* amerikane lidhur me shtetet në vijën e parë të frontit gjatë bombardimeve ajrore, funksionoi si një mjet stabilizues për negociatat zyrtare të Fuqive të mëdha, duke synuar të përforconte qëndrueshmërinë politike, të siguronte mbështetje logjistike dhe diplomatike për fushatën ajrore, si dhe të parandalonte përshkallëzimin e

---

<sup>8</sup> Ibid.

luftës përtej Kosovës. Pavarësisht garancive ekzistuese të sigurisë nga NATO, shtetet fqinje të Kosovës në vijën e parë frontit gjatë luftës ajrore, mbetën thellësisht të shqetësuara për ekspozimin e tyre ndaj hakmarrjes serbe dhe ndikimin socio-ekonomik të zhvendosjes masive nga Kosova. Duke pranuar se vetëm garancitë retorike kishin rezultuar të pamjaftueshme, politikëbërësit amerikanë arritën në përfundimin se nevojiteshin demonstrime më të dukshme dhe të prekshme mbështetjeje për të zhvilluar bashkëpunimin rajonal, si dhe për të parandaluar çarjet në koalicion.<sup>9</sup>

Për këtë qëllim, Zëvendës Sekretari i Shtetit Strobe Talbott, u ngarkua me drejtimin e një delegacioni të agjencive shtetërore amerikane për një vizitë diplomatike të profilit të lartë në Tiranë, Shkup, Sofje, Bukuresht dhe Bruksel në javën e parë të prillit të vitit 1999. Kohëzgjatja dhe itinerari i vizitës u koordinuan qëllimisht me planifikimet e takimit eventual të Grupit të Kontaktit, duke përforcuar perceptimin e angazhimit të vazhdueshëm diplomatik amerikan, pavarësisht se bombardimet e NATO-s vazhdonin. Ky sinkronizim nënvizoi porosinë kyçe të strategjisë amerikane, që ndërsa presioni ushtarak intensifikohej, kanalet diplomatike mbeteshin aktive dhe fuqiplota. Vizita e Talbott ishte gjithashtu e konceptuar që t'i paraprijë takimit të nivelit të lartë më 6 prill 1999 lidhur me ndihmën humanitare të thirrur nga Sadako Ogata, Komisionerja e Lartë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Në këtë mënyrë, diplomacia amerikane synonte të harmonizonte përpjekjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke përforcuar rolin e UNHCR-së dhe duke siguruar që shqetësimet humanitare të mos shfrytëzoheshin për të dobësuar vendosmërinë dhe efektivitetin e presionit ushtarak.<sup>10</sup>

Strategjia diplomatike e Shteteve të Bashkuara ilustronte një qasje holistike ndaj stabilitetit rajonal, duke kombinuar presionin ushtarak me mbështetje ekonomike dypalëshe. Në këtë kuadër, SHBA-të zhvillonin një paketë të re ndihme për shtetet fqinje të Kosovës në vijën e parë, e cila do të financohej përmes rialokimit të fondeve ekzistuese nga Programi i Mbështetjes për Demokracinë në Evropën Lindore (SEED). Kjo masë reflektonte një kuptim strategjik se stabiliteti rajonal kërkonte jo vetëm mbrojtje ushtarake, por edhe qëndrueshmëri ekonomike. Duke përdorur burimet ekzistuese në vend të fondeve të reja, politika amerikane synonte të vepronte shpejt, ndërkohë që

<sup>9</sup> Ibid.

<sup>10</sup> *Kosovo Diplomatic Strategy*, Memorandum, Department of State, March 27, 1999, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR., USA.

sinjalizonte angazhimin afatgjatë të Washingtonit ndaj rajonit. Tre prioritetet kryesore u identifikuan si qenësore për delegacionin e udhëhequr nga Strobe Talbott. *Së pari*, zyrtarët amerikanë riafirmuan angazhimin për të mos vendosur sanksione të reja kundër RFJ-së, meqë të njëjtat mund të dëmtonin ekonominë e brishta rajonale, si dhe duke anashkaluar shqetësimet për efektet anësore të luftës ekonomike kundër Beogradit. *Së dyti*, SHBA-të theksuan përforsimin e lidhjeve ndërmjet shteteve në vijën e parë të frontit dhe strukturave të NATO-s, duke përfshirë referencën ndaj politikës së anëtarësimit të “Dyerve të Hapura” të Aleancës, e cila ishte riafirmuar në Samitin e Washingtonit. Edhe pse anëtarësimi i menjëhershëm nuk ishte pjesë e ofertës, këto sinjale shërbyen për të integruar më thellë këto shtete brenda mekanizmave të sigurisë euroatlantike dhe për të orientuar bashkëpunimin e tyre gjatë luftës në Kosovë, si pjesë e një trajektoreje afatgjatë drejt integritimit. *Së treti*, dhe më me peshë për politikës amerikane, idhte se diplomacia amerikane duhej të punonte në koordinim me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, për të siguruar garanci të qarta se Aleanca do të përgjigjej ndaj çdo sulmi të RFJ-së ndaj shteteve fqinje të Kosovës në vijën e parë të frontit të luftës ajrore të NATO-s. Këto garanci synonin të parandalonin përshkallëzimin e luftës jashtë Kosovës dhe të siguronin qeveritë rajonale se afrimi i tyre me NATO-n nuk do t’i linte të ekspozuara ndaj kërcënimeve serbe. Në këtë mënyrë, SHBA-të zgjeruan në praktikë logjikën e mbrojtjes kolektive duke e shtrirë atë në mënyrë joformale tek shtetet jo-anëtare, duke reflektuar rrethanat e jashtëzakonshme të luftës së Kosovës.<sup>11</sup>

Në përgjithësi, strategjia fillestare diplomatike e SHBA-së gjatë luftës së Kosovës ilustronte një zbatim të kujdesshëm të diplomacisë shtrënguese brenda kufijve të kornizave institucionale formale. Forca ushtarake nuk përdorej si qëllim në vetvete, por si një instrument për të riformësuar mundësinë e zgjidhjes diplomatike, duke kufizuar veprimet e kundërshtarëve, ndërsa menaxhonte njëkohësisht Aleatët dhe partnerët. Mekanizmat kryesorë institucionalë – përfshirë Grupin e Kontaktit, NATO-n dhe Kombet e Bashkuara – u mobilizuan në mënyrë selektive për të legjitimuar kërkesat e SHBA-së, për të koordinuar veprimet shumëpalëshe dhe për të neutralizuar pasojat e padëshiruara, duke ruajtur kontrollin amerikan mbi ritmin dhe drejtimin e presionit detyrues diplomatiko-ushtarak. Në këtë kontekst, kufizimet institucionale nuk e dobësuan efikasitetin e diplomacisë, përkundrazi,

---

<sup>11</sup> Ibid.

ato strukturuan operacionalizimin e saj, duke siguruar që levat ushtarake, politike dhe diplomatike të harmonizoheshin në kanale të shumëfishta për të maksimizuar presionin mbi Millosheviqin, të mundësonin përfundimin e luftës dhe të ofronin stabilitet rajonal.

Këmbëngulja për të shmangur ndërprerjen e bombardimeve në mungesë të pajtueshmërisë dhe bindjes konkrete serbe, planifikimi i kujdesshëm i angazhimeve diplomatike dhe fokusi mbi unitetin e Aleancës pasqyronin një gjykim strategjik të politikës amerikane se besueshmëria e fuqisë perëndimore varej nga vendosmëria dhe qëndrueshmëria e saj. Njëkohësisht, vëmendja ndaj shteteve të vijës së parë të frontit dhe koordinimi i çështjeve humanitare nënvizonte se diplomacia shtrënguese kërkonte një mjedis rajonal të qëndrueshëm dhe mbështetje politike të konsoliduar.

Në retrospektivë, politika amerikane gjatë bombardimit ajror reflektonte një moment të rikalibrimit strategjik, ku domosdoshmëria e përshkallëzimit ushtarak u ngërthye me kërkesat për legjitimitet diplomatik. Strategjia e SHBA-së nuk u formësua vetëm nga shqetësimet operationale afatshkurtra, por edhe nga konsideratat më të gjera të menaxhimit të Aleancës, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe stabilitetit rajonal.

### **Përfaqësuesi Special Hollbruk në skenën diplomatike: Propozimet strategjike për përfundimin e luftës në Kosovë**

Richard Hollbruk, një nga diplomatët më të dalluar të administratës së Presidentit William J. Clinton, luajti një rol kyç në formësimin dhe zbatimin e politikës së Shteteve të Bashkuara gjatë luftës së Kosovës, duke përfshirë edhe gjatë bombardimeve ajrore të NATO-s në vitin 1999. I njohur për qasjen e tij të vendosur ndaj diplomacisë së krizave dhe përvojën e tij në zgjidhjen e konflikteve komplekse ndërkombëtare, Hollbruk u shfaq si arkitekt i një strategjie që synonte integrimin e presionit ushtarak me angazhimin diplomatik të qëndrueshëm. Përfshirja e tij pasqyrore një orientim më të gjerë amerikan, i cili synonte të detyronte pajtueshmërinë e regjimit serb përmes presionit të vazhdueshëm, duke ruajtur mundësinë e një zgjidhjeje të negociuar nën mbikëqyrjen ndërkombëtare.

Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Hollbruk mbështeti fuqimisht përdorimin e forcës ushtarake si instrument të diplomacisë shtrënguese, duke e perceptuar atë jo si një qëllim në vetvete, por si një mjet për të ndryshuar llogaritjet strategjike të Millosheviqit. Operationet ajrore u projektuan për të gjeneruar

ndikim diplomatik të mjaftueshëm për të siguruar tërheqjen e forcave serbe nga Kosova dhe pranimin e një pranie ndërkombëtare sigurie. Hollbruk theksoi vazhdimisht nevojën që veprimi ushtarak të integrohej brenda një kuadri politik më të gjerë, i orientuar drejt përfundimit të luftës, stabilizimit pas luftës dhe rindërtimit institucional. Memorandumet dhe rekomandimet e tij politike gjatë dhe pas bombardimeve nënvizuan domosdoshmërinë e përgatitjes për negociata edhe në fazat më intensive të fushatës ajrore. Si i dërguar Special i SHBA-së për Ballkanin, Hollbruk luajti një rol vendimtar ndërmjetësues gjatë pikës më kritike të luftës. Ai punoi për të konsoliduar unitetin e Aleancës, për të mobilizuar mbështetje ndërkombëtare për objektivat e NATO-s dhe për të ruajtur kanalet diplomatike me Beogradin, Moskën dhe kryeqytetet evropiane. Kjo qasje e dyfishtë – kombinimi i shtrengimit me angazhimin diplomatik – reflektoi një përpjekje të qëllimshme të SHBA-së për të shmangur kompromisin e parakohshëm dhe përshkallëzimin e pakontrolluar. Diplomacia e Hollbrukut veproi në kryqëzimin e presionit ushtarak dhe legjitimitetit institucional, duke forcuar besueshmërinë e NATO-s dhe duke ankoruar veprimet e saj brenda një kuadri ndërkombëtar të rregulluar. Veprimet e tij nxorën në pah mundësitë dhe kufizimet e lidërshiptit amerikan në rendin ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, veçanërisht në situata ku imperativat humanitare, interesat strategjike dhe legjitimiteti institucional duhej të ndërvepronin si një zë në mënyrë të ndërlikuar dhe efektive.<sup>12</sup>

Deri më 20 prill 1999, ndërsa fushata ajrore e NATO-s kundër Republikës Federale të Jugosllavisë hyri në javën e saj të katërt, politikëbërësit amerikanë u përballën me një situatë të vendnumërimit diplomatik që kishte nevojë të ndryshohej. Një memorandum i Richard Hollbrukut, i Dërguari Special i SHBA-së për Ballkanin, drejtuar Sekretarit të Shtetit, Këshilltarit të Sigurisë Kombëtare dhe Sekretarit të Mbrojtjes, i titulluar *Kosovo Next Steps* (Hapat e ardhshëm rreth Kosovës) adresoj çështjet strategjike të vazhdimit të bombardimeve ushtarake, drejtimin diplomatik amerikan, si dhe mënyren e bindjes politike e kapitulumin ushtarak serb - Millosheviqit. Memorandumi e konceptualizonte situatën si një bashkëveprim dinamik midis qëndrimit e mundësive të Millosheviqit dhe opsioneve të disponueshme për Shtetet e Bashkuara dhe Aleatët e saj. Ndërsa NATO kontrollonte tempon dhe intensitetin e bombardimeve, Millosheviqi kishte mundësinë për të menaxhuar

<sup>12</sup> Hadri, Arbër. *Politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes së Kosovës 1989-2008*. Instituti i Historisë “Ali Hadri”: Prishtinë, 2024, p. 45.

kohën dhe karakterin e çdo përgjigjeje fillestare politike ose diplomatike. Kjo asimetri theksonte një tipar qendror të mundësive vepruese të diplomacisë, që: dominimi ushtarak nuk garantonë automatikisht pajtueshmëri politike, veçanërisht kur kundërshtari-Milloshëviqi synonte të manipulonte kohën, kohezionin e Aleancës dhe implikimet humanitare.<sup>13</sup>

Hollbruku identifikoi tre skenarë kryesorë të veprimit që ishin në dispozicion të Millosheviqit, asnjë prej të cilëve nuk ofronte zgjidhje të favorshme nga perspektiva e tij politike. *Skenari i parë* përfshinte vazhdimin e sfidës ndaj NATO-s, me refuzimin e dorëzimit pavarësisht fushatës ajrore të vazhdueshme. Ky kurs supozonte se rezistenca e Serbisë, lodhja eventuale e Aleatëve ose ndërhyrja diplomatike e jashtme – veçanërisht nga Rusia – mund të dobësonin vendosmërinë e NATO-s me kalimin e kohës. Nga këndvështrimi i diplomacisë shtrënguese, ky opsion përfaqësonte përpjekjen e Millosheviqit për të sfiduar besueshmërinë e kërcënimeve perëndimore duke zgjatur luftën dhe duke përthithur ndëshkimin në pritje të përçarjeve brenda koalicionit kundër tij. *Skenari i dytë* përfshinte pranimin e kushteve të NATO-s, qoftë përmes kapitullimit të plotë, qoftë përmes një ndryshimi të udhëheqjes me një alternativë të gatshme për të përmbushur kërkesat perëndimore. Sipas vlerësimeve amerikane, kjo rrugë ishte më e drejta për të arritur objektivat e deklaruara të NATO-s, duke përfshirë tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, kthimin e refugjatëve dhe vendosjen e një pranie ndërkombëtare të sigurisë. Megjithatë, ky skenar nënkuptonte një humbje të konsiderueshme të pushtetit personal të Millosheviqit, duke e bërë atë opsionin më pak të pranueshëm për liderin serb si aktor politik. *Skenari i tretë* përfshinte një manovër më të pasigurt: pasi kishte shkaktuar zhvendosjen masive të popullsisë shqiptare nga Kosova, Millosheviqi mund të shpallte gatishmërinë për të negociuar dhe të paraqiste një ofertë të pjesshme ose të pasinqertë. Strategjikisht, një ofertë e tillë shihej nga diplomacia amerikane si një përpjekje për të përçarë NATO-n dhe Grupin e Kontaktit, për të shfrytëzuar shqetësimet humanitare dhe për ta ripërcaktuar luftën në Kosovë si një çështje që mund të zgjidhej përmes kompromisit diplomatik, duke shmangur presionin e fuqishëm të masave shtrënguese.

---

<sup>13</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 1-8, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

Ky opsion pasqyronte aftësinë e gjatë të Millosheviqit për manovrim taktik pa humbur pozicionin strategjik – një model që ishte evident në luftërat e mëparshme në ish-Jugosllavi.<sup>14</sup>

Analiza e Hollbruket më pas u fokusua tek zgjedhjet strategjike me të cilat përballeshin Shtetet e Bashkuara dhe Aleatët e saj, të përcaktuara në mënyrë të qartë nga veprimet e mundshme të Millosheviqit. Nëse Beogradi do të vazhdonte të rezistonte ndaj fushatës ajrore, Uashingtoni përballëhej me tre alternativa kryesore. *E para* përfshinte ndërprerjen e bombardimeve pa arritur objektivat e NATO-s. Hollbruk e shpërfilli këtë mundësi si një disfatë strategjike, pasi ajo do të shpërblente sfidën e Millosheviqit dhe do të dobësonte besueshmërinë perëndimore. Një rezultat i tillë do të kishte forcuar bindjen e udhëheqësit serb se rezistenca e tij mund të tejkalonte vendosmërinë e Aleancës. *Alternativa e dytë* parashikonte vendosjen e forcave tokësore në Jugosllavi në kushte të papërshtatshme, praktikisht një pushtim të pjesshëm ose të plotë të territorit. Ndërsa kjo qasje mund të sigurojë një ndikim ushtarak vendimtar, Hollbruk nënvizoi rreziqet e mëdha të një lufte të zgjatur dhe sfidat e administrimit të një popullsie të madhe dhe të rezistueshme. Kostot politike dhe ushtarake të lidhura me një përshkallëzim të tillë e bënë këtë opsion thellësisht jo tërheqës për shumë anëtarë të Aleancës dhe kërcënoi të dobësonte unitetin e NATO-s, duke minuar objektivat më të gjera diplomatike. *Alternativa e tretë*, sipas Hollbruket, përbëhej nga vazhdimi dhe intensifikimi i fushatës së bombardimeve ajrore. Ky opsion shmangte humbjen e menjëhershme ushtarake dhe rreziqet e një ndërhyrjeje tokësore, por e linte çështjen e pazgjidhur, duke zgjatur pasigurinë strategjike dhe vuajtjet humanitare. Holbrooke argumentoi se nëse administrata synonte të shmangte kapitullimin e detyruar ose ndërhyrjen tokësore, bombardimet duhej të vazhdonin dhe të intensifikoheshin deri në ndryshimin e sjelljes serbe, idealisht përmes një ndryshimi në lidhshmëri. Ky qëndrim reflektonte një parim thelbësor të diplomacisë shtrënguese, që “përshkallëzimi nuk justifikohet për vetë qëllimin e tij, por si një instrument i synuar për të riformësuar llogaritjen kosto-përfitim të kundërshtarit, duke detyruar pajtueshmërinë pa humbur kontrollin mbi ngjarjet”.<sup>15</sup>

Memorandumi i Përfaqësuesit Special Hollbruket i datës 20 prill 1999 ofronte, po ashtu, edhe një pasqyrë të thelluar mbi perceptimet e elitës

---

<sup>14</sup> Ibid.

<sup>15</sup> Ibid.

diplomatiqe amerikane për Slobodan Millosheviqin në një moment kritik të luftës në Kosovë. Dokumenti, hartuar gjatë fazës më intensive të fushatës së bombardimeve ajrore të NATO-s, kombinon vlerësimin strategjik me interpretimin psikologjik, duke reflektuar si pasigurinë ashtu edhe urgjencën që karakterizonte politikëbërjen e SHBA-së në atë periudhë. Hollbruk e paraqiti Millosheviqin jo vetëm si një udhëheqës autoritar me aftësi racionale, por edhe si një participues në ngjarje, sjellja e të cilit dukej gjithnjë e më e çrregullt, e dëshpëruar dhe potencialisht vetëshkatërruese. Ky portret zbulon përplasjen midis vlerësimeve strategjike dhe shqetësimeve psikologjike të Shteteve të Bashkuara, duke nënvizuar sfidën që paraqiste ndërveprimi me një kundërshtar që mund të kishte reagime jo të parashikueshme, por që njëkohësisht posedonte kapacitet të konsiderueshëm për të influencuar ritmin dhe karakterin e luftës. Në këtë kuadër, perceptimi i Hollbrukut reflekton një interpretim të kujdesshëm të rreziqeve operative dhe diplomatike që dilnin nga një udhëheqës i perceptuar si i paparashikueshëm, duke e bërë diplomacinë amerikane një përpjekje të ndërlikuar për të balancuar shtrëngimin strategjik diplomatik dhe ushtarak me menaxhimin e pasojave të mundshme të sjelljes së Millosheviqit.<sup>16</sup>

Në qendër të analizës së Hollbrukut qëndronte kontrasti midis “Millosheviqit të Dejtonit” dhe Millosheviqit lidhur me Kosovën. Gjatë negociatave për Marrëveshjen e Dejtonit, Millosheviqi kishte demonstruar një profil llogaritës dhe pragmatik si bashkëbisedues, i gatshëm të sakrifikonte interesat e serbëve në Bosnjë dhe Kroaci në këmbim të legjitimitetit ndërkombëtar, lehtësimit të sanksioneve dhe riintegrimit në strukturat politike dhe ekonomike evropiane. Hollbruk theksonte se Millosheviqi kishte arritur përparime të prekshme drejt këtyre objektivave, duke përfituar nga njohja ndërkombëtare, marrëveshjet ekonomike të favorshme dhe një plan rrugor i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara, i cili lidhte pajtueshmërinë me Dejtonin me përfitime konkrete për regjimin. Megjithatë, lufta në Kosovë shënoi një ndërprerje të thellë të kësaj trajektoreje. Sipas Hollbrukut, aspiratat e Millosheviqit për pranim ndërkombëtar u dëmtuan në mënyrë të pakthyeshme, duke e kthyer udhëheqësin nga një aktor pragmatik dhe i integruar në rendin

---

<sup>16</sup> Richard Holbrooke, *Some Thoughts about Slobodan Milosevic*, memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

ndërkombëtar në një kundërshtar të izoluar dhe të vështirë për t'u negociuar.<sup>17</sup>

Memorandumi argumentonte se Millosheviqi arriti të kuptonte se kishte kaluar një pikë pa kthim. I izoluar në skenën ndërkombëtare, i paaftë për të udhëtuar pa rrezikuar arrestimin dhe përballë shkatërrimit ekonomik të Jugosllavisë, ai nuk mund të llogariste më në rehabilitim apo mbështetje perëndimore. Hollbruk vlerësoi se ky realizim kishte transformuar sjelljen e Millosheviqit në Kosovë, duke prodhuar një model dhune ekstreme, i orientuar drejt shkaktimit të vuajtjeve maksimale mbi popullsinë shqiptare, pavarësisht kërcënimit për rrënimin politik afatgjatë. Ky ndryshim u interpretua si tregues i një udhëheqësi që nuk besonte më në mbijetesën e tij politike dhe vepronte duke u përshtatur me realitetet e kufizuara që përballlej. Analiza e Hollbruk pasqyroi gjithashtu logjikën e diplomacisë shtrënguese që nënvizonte strategjinë e SHBA-së, se Millosheviqi mund të kishte nënvlerësuar vendosmërinë e NATO-s, duke supozuar një fushatë të kufizuar të bombardimeve, të ngjashme me “Operacionin Dhelpra e Shkretëtirës” në Irak në vitin 1998. Ndërsa shkalla dhe kohëzgjatja e bombardimeve u bënë të qarta, Hollbruk vlerësoi se perspektivat e Millosheviqit për mbijetesë u zvogëluan më tej, duke justifikuar nevojën për presion të vazhdueshëm dhe intensifikim të fushatës.<sup>18</sup>

Në terma të përgjithshëm, memorandumi ilustron mënyrën se si diplomacia amerikane gjatë luftës në Kosovë integronte analizën strategjike me vlerësimin psikologjik të lidërshiptit kundërshtar, duke trajtuar izolimin dhe marginalizimin përfundimtar të Millosheviqit si elementë thelbësorë për arritjen e objektivave të kombinimit të presionit ushtarak dhe politik.

### **Ndërmjet triumfit ushtarak, bindjes dhe diplomacisë shtrënguese**

Ndërmjet skenarit në të cilin Beogradi pranonte kushtet e NATO-s apo nëse Millosheviqi do të humbiste pushtetin, Hollbruk konstatoi se objektivat strategjike të Shteteve të Bashkuara dhe të Aleancës mund të realizoheshin plotësisht. Një rezultat i tillë përfaqësoi një fitore të qartë strategjike, duke vërtetuar fuqinë ushtarake ajrore si një instrument efektiv të detyrimit diplomatik. Megjithatë, memorandumi e njohu në mënyrë implicite pasigurinë e arritjes së një rezultati të tillë, duke theksuar nevojën për një

---

<sup>17</sup> Ibid.

<sup>18</sup> Ibid.

planifikim të kujdesshëm në skenarët më pak të favorshëm. Situata bëhej veçanërisht komplekse nëse Millosheviqi do të ofronte një propozim gjysmë serioz negociues, i cili nuk përmbushte objektivat kryesore të NATO-s. Në këtë kontekst, Shtetet e Bashkuara do të përballëshin me vendime delikate që mund të kontestonin kohezionin brenda Aleancës dhe Grupit të Kontaktit. Pyetja kyçe mbetej nëse angazhimi negociator me Millosheviqin ishte i pranueshëm nga perspektiva strategjike apo në të kundërt, ishte një rrezik potencial që mund të dobësonte presionin e ushtruar mbi regjimin serb.<sup>19</sup>

Hollbruk bëri një krahasim të qartë me Marrëveshjet e Dejtonit, duke vlerësuar se ato kishin përfshirë trajtimin e një përfaqësuesi politik të pakëndshëm, por kishin arritur të vendosnin një fund të pranueshëm për Luftën e Bosnjës. Ai theksoi se Millosheviqi kishte respektuar në masë të mjaftueshme kornizën e Dejtonit, veçanërisht për sa i përket shmangies së viktimave të NATO-s dhe të amerikanëve, gjë që e justifikonte vazhdimin e angazhimit diplomatik. Megjithatë, Dejtoni e kishte rilegjitimuar politikisht dhe e kishte fuqizuar ekonomikisht Serbinë përmes angazhimit ndërkombëtar. Pas luftës së Kosovës, Hollbruk argumentoi se legjitimiteti politik i Millosheviqit ishte rrënjësisht i kompromentuar.

Qëllimet e tij mbeteshin të pandryshuara: ruajtja e pushtetit, kontrolli mbi Kosovën dhe shmangia e përgjegjësisë për veprimet e tij. Hollbruk e konsideroi politikisht dhe moralisht të papranueshme mundësinë që Millosheviqi të luante rol garues në të ardhmen e Kosovës, duke theksuar se shkalla e dhunës dhe zhvendosjes së popullsisë shqiptare e kishte bërë një skenar të tillë të papranueshëm. Ai gjithashtu parashikoi se mjedisi ndërkombëtar pasluftës do të karakterizohej nga kërkesat për drejtësi, duke krijuar presion të konsiderueshëm publik kundër çdo marrëveshjeje që do ta linte Millosheviqin në pushtet, pavarësisht nga meritat strategjike të saj. Në këtë kontekst, roli i institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë fitoi një rëndësi të veçantë. Ndryshe, në krahasim me pas Dejtonit, kur të akuzuarit për krime lufte si Radovan Karaxhiç dhe Ratko Mlladiç mbetën të lirë, Hollbruk supozoi se Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, nën drejtimin e Kryeprokurores Louise Arbour, do të padiste Millosheviqin. Kjo pritje vendosi kufizime të konsiderueshme mbi çdo marrëveshje diplomatike që

---

<sup>19</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 1-8, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

përfshinte vazhdimin e sundimit të tij, duke riformuluar kufijtë e mundshëm të negociatave dhe strategjive diplomatike të SHBA-së.<sup>20</sup>

Në këtë kontekst politikë e SHBA-së ishte ndryshimi i regjimit si njëri ndër objektivat themelor strategjik të fushatës ajrore. Largimi i udhëheqësit të Jugosllavisë u perceptua si një veprim i duhur stabilizues dhe i dëshirueshëm. Megjithëse nuk ekzistonte asnjë informacion konkret që të sinjalizonte një largim të afërt të Millosheviqit, Hollbruk shprehu një bindje të fortë se pozicioni i tij politik ishte i paqëndrueshëm, edhe nëse koha dhe mënyra e largimit mbeteshin të pasigurta. Në memorandum u theksuan edhe shembuj historikë ku udhëheqës të vendosur, si Winston Churchill, refuzuan të përfshiheshin në komplete kundër Adolf Hitlerit. Megjithatë, Hollbruk argumentoi se regjimi i Millosheviqit dallonte thelbësisht nga diktaturat më të forta. Ai e përshkroi Jugosllavinë si një “diktaturë të butë”, më i ngjajshëm me regjimin e Markos sesa me ato të Sadam Huseinit ose Nicolae Çausheikut. Shoqëria serbe mungonte në kohezionin ideologjik karakteristik të sistemeve më totalitare, dhe Millosheviqi vetë ishte gjerësisht i pabesueshëm dhe jopopullor. Edhe pse periudha e luftës forcoi përkohësisht unitetin kombëtar serb, Hollbruk theksoi se ky kohezion nuk kishte gjasa të qëndronte në aspektin afatgjatë.<sup>21</sup>

Hollbruk sugjeroi se anëtarët e rrethit të ngushtë të Millosheviqit mund të kërkonin distancimin prej tij, veçanërisht nëse e perceptonin vazhdimin e sundimit të tij si një pengesë për interesat e tyre personale ose politike. Rihapja e kanaleve të komunikimit me zyrtarët perëndimorë mund të shërbente si një instrument për të lehtësuar këtë distancim, duke krijuar mundësi për ndikim të brendshëm pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë nga jashtë. Megjithatë, çdo përpjekje për të larguar Millosheviqin do të varej në mënyrë thelbësore nga mbështetja e Ushtrisë Jugosllave dhe e akterëve kryesorë ekonomikë, duke nxjerrë në pah kufizimet e ndikimit të jashtëm në vendimmarrjen e brendshme të regjimit. Ndërsa Hollbruk pranoi rrezikun që një zëvendësues potencial mund të ishte një nacionalist më ekstrem, ai e vlerësoi këtë si një rrezik të pranueshëm, në dritën e objektivave strategjike më të gjerë, duke privilegjuar mundësinë e ndryshimit të regjimit dhe stabilizimit rajonal mbi pasigurinë e përkohshme politike.<sup>22</sup>

---

<sup>20</sup> Ibid.

<sup>21</sup> Ibid.

<sup>22</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 1-8, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

Edhe pse Hollbruk shprehu një preferencë të qartë për largimin e Millosheviqit, ai paralajmëroi se politika amerikane duhej të mbështetej në mundësinë reale që ai të vazhdonte të qëndronte në pushtet më gjatë se sa dëshirohej. Në këtë kontekst, negociatat me regjimin e tij mund të bëheshin të pashmangshme, duke kërkuar një qasje pragmatike dhe të kujdesshme. Hollbruk vlerësoi se paqartësia publike e administratës mbi ndryshimin e regjimit funksiononte, duke ruajtur fleksibilitetin e politikës dhe duke shmangur angazhime të parakohshme dhe duke lejuar përshtatjen e veprimeve ndaj zhvillimeve të paparashikuara në terren.<sup>23</sup>

Në rast se do të zhvilloheshin negociata, diplomacia amerikane identifikoi disa parime thelbësore. *Së pari*, bombardimet duhej të vazhdonin gjatë gjithë procesit të bisedimeve. Pritej që Millosheviqi të kërkonte një lidhje ndërmjet negociatave dhe ndërprerjes së operacioneve ajrore një pozicion që mund të mbështetej nga Rusia dhe disa Aleatë të NATO-s. Hollbruk argumentoi se çdo lëshim në këtë pikë do të minonte logjikën e diplomacisë shtrënguese dhe këmbënguli që presioni ushtarak të mbetej konstant. *Së dyti*, përzgjedhja e bashkëbiseduesve ishte kritike. Bisedimet e drejtpërdrejta me Millosheviqin rrezikonin të forconin personalitetin e tij, megjithatë vetëm ai zotëronte autoritetin për të finalizuar një marrëveshje. Kur ishte e mundur, Hollbruk preferonte negociatat me vartës të fuqizuar, veçanërisht ata që kërkonin mbijetesë personale ose politike të pavarur nga fati i Millosheviqit. *Së treti*, vendndodhja e negociatave përbënte një sfidë serioze. Millosheviqi nuk kishte gjasa të largohej nga Jugosllavia për shkak të frikës nga arrestimi ose përmbysja, duke bërë bisedimet në Beograd gjatë bombardimeve të NATO-s si jopraktike, ashtu edhe problematike në aspekt simbolik. *Së katërti*, zhvillimi i negociatave ishte i kufizuar nga politika e Aleancës dhe Grupit të Kontaktit. Ndërsa partnerët nuk mund të përjashtoheshin zyrtarisht, Hollbruk theksoi se negociatat efektive kërkonin privatësi dhe vendosmëri. Një konferencë mund të bashkëkryesohej nominalisht nga Shtetet e Bashkuara, Rusia dhe një përfaqësues evropian, por bisedimet kyçe duhej të zhvilloheshin nga SHBA, ndërsa të tjerët mbaheshin të informuar. Kjo reflektonte realitetin se Shtetet e Bashkuara mbanin barrën kryesore ushtarake dhe politike të fushatës. Së fundi, Hollbruk paralajmëroi se ishte kundër lejimit që Millosheviqi të negocionte në mënyrë indirekte përmes ndërmjetësve alternativë si Rusia, Kombet e Bashkuara ose shtete simpatizante. Çdo përpjekje e tillë për të anashkaluar

---

<sup>23</sup> Ibid.

objektivat e fushatës ajrore përtej kontrollit amerikan u konsideruan të papranueshme.<sup>24</sup>

Në përfundim të analizës së pjesës së parë të strategjisë, Hollbruk rekomandoi që çdo bisedë me qeverinë jugosllave të zhvillohej jashtë territorit të Jugosllavisë, duke u fokusuar tek vartës të fuqizuar dhe jo tek vetë Millosheviqi, ndërkohë që vazhdonin përpjekjet për të minuar autoritetin e tij dhe për të nxitur largimin e tij.

Artikuli i synimeve të NATO-s ishte kristalizuar rreth tre objektivave urgjente dhe të ndërlidhura. Së pari, kthimi i refugjatëve në shtëpitë e tyre në Kosovë u identifikua me përparësi duke nënvizuar domosdoshmërinë e sanimit humanitar, sikurse edhe domosdoshmërinë politike për përmbysjen e spastrimit etnik. Së dyti, tërheqja e forcave jugosllave të sigurisë përfshirë ushtrinë dhe policinë u konsiderua e domosdoshme për të parandaluar dhunën e mëtejshme dhe për të krijuar kushtet për sigurinë civile. Së treti, vendosja e një force ndërkombëtare sigurie në Kosovë, e aftë të vepronte në një mjedis të sigurt dhe të mbikëqyrur, shihej si element thelbësor për stabilizimin e Kosovës dhe garantimin e qëndrueshmërisë së çdo zgjidhjeje politike. Së bashku, këto qëllime nënvizuan kalimin nga një shtrëngim ushtarak i kufizuar drejt një axhende më të gjerë, ku presioni i NATO-s lidhej drejtpërdrejt me rezultate konkrete politike dhe humanitare, duke integruar elementet e sigurisë, mbrojtjes civile dhe drejtësisë ndërkombëtare në një strategji të unifikuar.<sup>25</sup> Reciprociteti u konsiderua gjithashtu si një komponent kyç i kuadrit strategjik. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) pritej të pranonte një armëpushim si pjesë e çdo marrëveshjeje përfundimtare. Megjithatë, çarmatimi i UÇK-së i përfshirë zyrtarisht në Marrëveshjet e Rambujesë paraqiste një sfidë më komplekse dhe kontestuese.

Në këtë fazë të luftës, UÇK-ja kishte konsoliduar ndikimin e saj në terren, duke e komplikuar zbatimin e një procesi të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës të demilitarizimit. Megjithatë, këto sfida nuk e reduktuan rëndësinë e objektivave kryesore të NATO-s, të cilat u përcaktuan si kushtet e pakompromis për përfundimin e suksesshëm të fushatës së bombardimeve ajrore.<sup>26</sup>

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 4, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

<sup>26</sup> Ibid.

Politikëbërësit amerikanë pritnin që çdo propozim i Millosheviqit do të dështonte në përmbushjen e objektivave kryesore të NATO-s. Beogradi ishte i prirur të ndiqte një seri dredhish taktike për të ruajtur kontrollin maksimal dhe për të bërë sa më pak lëshime të mundshme. Këto përfshinin përpjekje për të penguar kthimin e refugjatëve, mbajtjen e elementëve të forcave jugosllave të sigurisë dhe të forcave kufitare në Kosovë, dhe propozime për të rikthyer praninë e forcave në nivelet e tetorit 1998 ose në dispozitat selektive të Rambujesë. Në mënyrë të ngjashme, Millosheviqi pritej të kundërshtonte praninë e një force ndërkombëtare sigurie ose të propozonte një variant që përjashtonte qartë trupat e NATO-s. Të gjitha këto manovra u perceptuan si përpjekje për të dobësuar objektivat e Aleancës dhe për të shfrytëzuar ndarjet brenda saj dhe të Grupit të Kontaktit. Hollbruk theksoi se çdo propozim i tillë duhej të refuzohej pa kompromis për të ruajtur besueshmërinë e diplomacisë amerikane. Dimensionet politike të zgjidhjes u identifikuan si edhe më komplekse. Pritshmëritë ishin se çështjet kryesore nuk mund të zgjidheshin plotësisht gjatë fazës fillestare të negociatave, megjithëse progresi aty ku ishte i mundur mbeti i dëshirueshëm. Marrëveshja e Rambujesë nuk përmbushte plotësisht pritshmëritë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila kishte konsoliduar rolin e saj si faktor politik dominues midis shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, shumica e parimeve themelore të Rambujesë veçanërisht ato lidhur me qeverisjen, praninë ndërkombëtare dhe garancitë për të drejtat e njeriut vazhdonin të konsideroheshin të vlefshme në aspektin ndërkombëtar. Kështu, këto parime priteshin të formonin shtyllën kurrizore të një marrëveshjeje më të gjerë kornizë që do të shoqëronte ndërprerjen e bombardimeve, duke ilustruar se qëllimet e NATO-s kishin evoluar në përputhje me zhvillimet në terren, pa devijuar nga logjika themelore e strategjisë së saj.<sup>27</sup>

### **Kosova pas bombardimeve: Statusi, mbështetja humanitare, rindërtimi, stabiliteti rajonal dhe roli i Rusisë**

Ndërsa politikëbërësit amerikanë përgatiteshin për përfundimin e fushatës ajrore të NATO-s, vëmendja u zhvendos gradualisht drejt arkitekturës politike, humanitare dhe rajonale që do të pasonte ndërprerjen e armiqësive. Faza pas bombardimit, nga SHBA-të nuk shihej si një moment përfundimtar, por si një proces kompleks dhe afatgjatë që kërkonte angazhim të vazhdueshëm

---

<sup>27</sup> Ibid.

ndërkombëtar. Vendimet e marra në këtë periudhë priteshin të formësonin jo vetëm statusin e ardhshëm politik të Kosovës, por edhe stabilitetin më të gjerë të Evropës Juglindore dhe besueshmërinë afatgjatë të ndërhyrjes perëndimore.

Një nga çështjet qendrore lidhej me statusin politik dhe ligjor të Kosovës pas përfundimit të operacioneve ushtarake të NATO-s. Njëri ndër opsionet kryesore në shqyrtim ishte vendosja e një kujdestarie ndërkombëtare, e autorizuar sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Një rregullim i tillë, sipas qëndrimit amerikan, nuk do ta ndryshonte zyrtarisht statusin e Kosovës si pjesë nominale të Jugosllavisë sipas ligjit ndërkombëtar, por do ta hiqte Kosovën nga kontrolli efektiv i Beogradit për një periudhë të caktuar kalimtare deri te zgjidhja përfundimtare e statusit. Kjo qasje synonte të balanconte dy qasje konkurrues: ruajtjen e respektimit formal të normave ndërkombëtare ekzistuese, dhe izolimin e qeverisjes së Kosovës nga regjimi përgjegjës për krime kundër njerëzimit, mizorive, dhunën masive dhe spastrimin etnike të popullsisë shqiptare. Në këtë kontekst, ndarja u konsiderua gjerësisht si një zgjidhje problematike, e cila mbartte rreziqe të mëdha për legjitimitetin ndërkombëtar, konsolidimin e spastrimit etnik dhe vendosjen e precedentëve destabilizues në rajon. Megjithatë, politikëbërësit përkohësisht nuk e përjashtuan plotësisht mundësinë e krijimit të zonave të kontrollit ndërkombëtar, si një masë sigurie emergjente. U paraqitën analogji me përvojat e Bregut Perëndimor, ku autoriteti i diferencuar ishte përdorur për menaxhimin e qeverisjes kalimtare në mjedise shumë të kontestuara. Marrëveshje të tilla, nëse do të miratoheshin, konceptoheshin si instrumente rreptësisht kalimtare dhe funksionale, dhe jo si hapa drejt ndarjes së përhershme territoriale.<sup>28</sup>

Dimensionin e katastrofës humanitare i luftës së Kosovës doli në pah si një ndër rastet më të paprecedentë në Evropën e pasluftës, madje edhe para përfundimit të vlerësimeve gjithëpërfshirëse. Ndërsa përcaktimi i saktë sasior mbeti i pamundur gjatë vazhdimit të luftës, përmasat e katastrofës ishin të qarta dhe të pakontestueshme. Shumë zona të Kosovës kishin pësuar shkatërrime sistematike të strehimit dhe infrastrukturës bazë, ndërsa komunitetet rurale, që përbënin pjesën më të madhe të popullsisë, humbën kapacitetin për të rivendosur jetesën bujqësore përpara sezonit të ardhshëm të mbjelljeve. Pusët

<sup>28</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 5-6, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

ishin të kontaminuara ose të shkatërruara, bagëtia ishte eliminuar dhe rezervat ushqimore shteruan. Afërsia e dimrit përkeqësoi dramatikisht situatën, duke bërë që nevoja për ndihmë emergjente të tejkalonte edhe vlerësimet më të larta ekzistuese. Komuniteti ndërkombëtar parashikoi nevojën për të siguruar strehim të përkohshëm dhe jetesë për rreth një milion njerëz gjatë dimrit 1999–2000, e pasuar nga një proces afatgjatë rindërtimi që do të zgjaste disa vite. Madhësia dhe kompleksiteti i ndërmarrjes nënvizuan ironinë tragjike të hyrjes në mijëvjeçarin e ri ndërmjet spastrimit etnik dhe kolapsit humanitar.<sup>29</sup>

Në dritën e këtyre realiteteve, emërimi i një koordinatori të nivelit të lartë për ndihmën humanitare në Kosovë u pa si një domosdoshmëri urgjente. Ky pozicion kërkonte autoritet për të vepruar përtej kufijve të ndër-agjencive, duke kapërcyer fragmentimin burokratik që historikisht kishte penguar reagimin efektiv ndaj krizave humanitare. Shkalla dhe kompleksiteti i sfidës humanitare kërkonin një udhëheqje të centralizuar, në gjendje të integronte ofrimin e sigurisë, ndihmën emergjente dhe planifikimin afatgjatë të rindërtimit, në kuadër të një strategjie koherente dhe të koordinuar.

Përtej Kosovës, rajoni më i gjerë përballej me presione akute që kërcënonin stabilitetin e brishtë pas Luftës së Ftohtë në Evropën Juglindore. Shqipëria dhe Maqedonia identifikoheshin si vende veçanërisht të prekshme, secila me probleme të theksuara politike, ekonomike dhe shoqërore. Fluksi masiv i refugjatëve krijoi një barrë të paqëndrueshme mbi kapacitetet e kufizuara institucionale të këtyre shteteve, ndërsa afërsia e luftës rriti tensionet etnike dhe politike të brendshme. Të dy vendet kërkonin ndihmë emergjente që tejkalonte nivelin ekzistues të mbështetjes ndërkombëtare, për të shmangur një destabilizim më të thellë. Shtete të tjera fqinje, përfshirë Malin e Zi, u përballën gjithashtu me kosto të konsiderueshme, qoftë përmes rënies ekonomike, presionit politik nga Beogradi, apo ekspozimit ndaj pasigurisë rajonale. Bosnja dhe Hercegovina, megjithëse nuk ishte e përfshirë drejtpërdrejt në luftën e Kosovës, mbeti një shqetësim qendror i politikës së jashtme amerikane. Çdo pengesë në stabilitetin e Bosnjës do të kishte vënë në pikëpyetje tërësinë e politikës perëndimore në Ballkan që nga Dejtoni, duke minuar si besueshmërinë e NATO-s, ashtu edhe qëndrueshmërinë e përpjekjeve ndërkombëtare për ndërtimin e shtetit. Për këtë arsye, sipas SHBA-së Bosnja pritej të qëndronte në krye të axhendës ndërkombëtare, duke kërkuar vëmendje të vazhdueshme politike dhe mbështetje materiale.<sup>30</sup>

---

<sup>29</sup> Ibid.

<sup>30</sup> Ibid.

Duke parë përtej luftës së menjëhershme, politikëbërësit amerikanë kishin qendrim se stabiliteti rajonal do të kërkonte, në mënyrë të pashmangshme, angazhim edhe me vetë Serbinë, jashtë kontekstit të Kosovës. Ndërsa ishte politikisht dhe moralish e parakohshme të konsiderohej ndihma humanitare apo rindërtimi i drejtpërdrejtë për Serbinë përderisa Millosheviqi mbetej në pushtet, u njoh se objektivi afatgjatë – krijimi i një shteti serb të qëndrueshëm dhe demokratik – mbetej thelbësor. Ky qëllim u pajtua në parim jo vetëm nga Shtetet e Bashkuara, por edhe nga Bashkimi Evropian dhe Rusia. Rindërtimi i pjesës tjetër të Jugosllavisë u konceptua jo si një akt lëshimi ndaj Millosheviqit, por si një investim strategjik, i destinuar për të nxitur normalizimin rajonal sapo kushtet politike të lejonin një angazhim të tillë të qëndrueshëm.<sup>31</sup>

Roli i Ruisë në fazën pas bombardimeve u vlerësua nga ana e politikës amerikane në prizmin e një kombinimi ndërmjet kujdesit dhe pragmatizmit. Gjatë bombardimeve të NATO-s, kishte indikacione se Moska po rivlerësonte kostot e angazhimit të saj përkrah Millosheviqit dhe dëmëve në relacionin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Veprime të tilla, përfshirë bisedimet e Sekretarit të Shtetit në Oslo dhe vendimin për të mbajtur trupat ruse të vendosura në Bosnjë, u interpretuan si përpjekje për të kufizuar ndikimin e luftës së Kosovës mbi marrëdhëniet e Ruisë me Perëndimin. Këto lëvizje, kryesisht retorike, pasqyronin një përpjekje për të menaxhuar tensionet brenda kufijve të kontrollueshëm, pavarësisht presionit të brendshëm nga grupe nacionaliste dhe anti-perëndimore që shfrytëzonin çështjen e Kosovës për qëllime politike. Megjithatë, politikëbërësit amerikanë hodhën poshtë idenë se Rusia mund ose do të vepronte si një ndërmjetëse vendimtare për të arritur një zgjidhje që të përmbushte objektivat perëndimore. Pritjet se Moska mund të “shpëtonte” NATO-n në plan diplomatik u konsideruan të parakohshme dhe iluzore nga ana e politikës amerikane. Në të vërtetë, përfshirja e Ruisë në një rol qendror në negociata rrezikonte të çonte në kompromise të papranueshme për Uashingtonin dhe Aleatët e saj. Refuzimi publik i këtyre kompromiseve mund të kishte për pasojë përkeqësimin e marrëdhënieve bilaterale me Rusinë, duke minuar qëllimin e parësishëm të një përfshirjeje të tillë: ruajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërkombëtare.<sup>32</sup>

Si rrjedhojë, qasja e preferuar konsistonte në mbajtjen e një komunikimi të vazhdueshëm dhe të ngushtë me Moskën, pa i dhënë Ruisë një rol të

---

<sup>31</sup> Ibid.

<sup>32</sup> Ibid.

thelluar në negociatat bazë. Kjo strategji synonte të mbronte marrëdhënien afatgjatë ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, duke shmangur rrethana në të cilat Moska do të diskreditohej publikisht ose do të marginalizohej pas investimit të konsiderueshëm të kapitalit politik në përpjekjet ndërmjetësuese. Në këtë kontekst, menaxhimi i rolit të Rusisë kishte të bënte po aq me ruajtjen e stabilitetit strategjik të rendit pas Luftës së Ftohtë, sa edhe me adresimin e vetë luftës së Kosovës.<sup>33</sup>

Në përmbledhje, faza pas bombardimeve u konceptua si një sfidë thelbësisht shumëdimensionale, që përfshinte njëkohësisht çështjet e qeverisjes, rindërtimin humanitar, stabilizimin rajonal dhe dinamikat e marrëdhënieve ndërmjet fuqive të mëdha. Perspektiva e vendosjes së një kujdestarie ndërkombëtare në Kosovë, shkalla e paprecedentë e ndihmës humanitare të nevojshme, brishtësia strukturore e shteteve fqinje dhe menaxhimi i kujdesshëm i rolit të Rusisë nënvizuan faktin se lufta e Kosovës shtrihej përtej kufijve të një fushate të kufizuar ushtarake. Në këtë kontekst, politika e Shteteve të Bashkuara gjatë fazës së pas luftës parashikohej të kishte një kuptim të qartë se sukcesi i vërtetë nuk do të matej vetëm me ndaljen e luftës, por edhe me ndërtimin e një rendi të qëndrueshëm politik dhe të sigurisë në rajonin e Ballkanit, të aftë për të parandaluar rikthimin e armiqësive.

### **Opsioni i përfshirjes së forcave tokësore të SHBA-së dhe NATO-s në luftën e Kosovës**

Debati mbi përfshirjen e forcave tokësore të SHBA-së dhe NATO-s në luftën në Kosovë ishte çështje më më e kontestuar dhe politikisht më e ndjeshme. Në diskursin publik dhe institucional, Shtetet e Bashkuara dhe Aleatët e tyre u përballën me një kritikë gjithnjë e më të artikuluar, e cila e interpretonte mungesën e një opsioni të qartë tokësor jo thjesht si një zgjedhje operacionale, por si tregues të një mungese më të thellë koherence strategjike. Ky interpretim kontribuoi në delegjitimimin gradual të narrativës zyrtare mbi efektivitetin e strategjisë së bombardimeve ajrore dhe në rritjen e presionit politik mbi vendimmarrësit. Ky perceptim kritik u formësua nga ndërveprimi i tre faktorëve të ndërlikur. Së pari, ekzistonte një bindje e përhapur e rrënjësor si në përvojat historike ashtu edhe në literaturën strategjike se fushatat e

---

<sup>33</sup> Ibid.

bombardimeve ajrore të izoluara ishin strukturalisht të kufizuara në aftësinë e tyre për të prodhuar rezultate politike vendimtare, veçanërisht në konfliktet që përfshinin kontroll territorial dhe dhunë sistematike ndaj popullsisve civile. Së dyti, zgjatja e fushatës së bombardimeve, e shoqëruar me mungesën e treguesve të qartë të përparimit politik, nxiti një ndjenjë në rritje padurimi dhe skepticizmi si në opinionin publik ashtu edhe në media, duke e përforcuar perceptimin e një ngërçi strategjik. Së treti, kritikët e administratës amerikane me senatorin John McCain si zërin më të spikatur arritën të artikulojnë këtë pakënaqësi në terma politikisht të fuqishëm, duke e akuzuar NATO-n për mungesë planifikimi dhe për dështim në ruajtjen e besueshmërisë së kërcënimit shtrëngues përmes përjashtimit apriori të operacioneve tokësore. Në bashkëveprim, këto dinamika krijuan një mjedis presioni të shtuar politik dhe strategjik ndaj SHA-së dhe Aleatëve të saj në NATO, në të cilin kostoja e mosangazhimit tokësor filloi të rivalizonte rreziqet reale të përshkallëzimit ushtarak.<sup>34</sup>

Në këtë kuadër, gjatë luftës së Kosovës dhe debatit të brendshëm amerikan mbi shkallën e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë ushtarake, u shfaqën edhe iniciativa konkrete legjislative që reflektuan orientime të ndryshme të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara. Një ndër to ishte projektligji i Kongresit Amerikan i titulluar *Kosovo Self-Defense Act*, i paraqitur në vitin 1999 nga përfaqësuesi Eliot Engel dhe senatorët Mitch McConnell dhe Joseph Lieberman, i cili përbënte një artikulum të rëndësishëm të qasjes amerikane ndaj luftës në Kosovë. Nisma synonte ofrimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë ushtarake për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe për popullsinë civile, përmes një programi ndihme sigurie në vlerë prej 25 milionë dollarësh, me qëllim forcimin e kapaciteteve lokale të vetëmbrojtjes përballë agresionit serb. Thelbi politik i kësaj qasjeje pasqyronte bindjen në rritje brenda Kongresit amerikan se pavarësia e Kosovës ishte e pashmangshme dhe se fuqizimi i akterëve vendas përbënte një interes strategjik të politikës së jashtme amerikane. Në të njëjtën kohë, projektligji e konceptonte trajnimin dhe asistencën ushtarake si instrument për të kufizuar angazhimin e drejtpërdrejtë amerikan, duke e paraqitur këtë model si alternativë ndaj dislokimit të trupave tokësore. Edhe pse nuk u miratua, kjo iniciativë shënoi një moment domethënës në evolucionin

<sup>34</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 6-7, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

e politikës amerikane ndaj Kosovës, duke sinjalizuar një zhvendosje drejt mbështetjes së forcave lokale dhe duke e kornizuar pavarësinë e Kosovës si një domosdoshmëri politike dhe sigurie në arkitekturën euroatlantike.<sup>35</sup>

Supozimi mbizotërues se fushata ajrore kishte dështuar që në fillim mbështetej më shumë në hamendësime sesa në prova empirike. Megjithëse pranohej gjerësisht se fuqia ajrore kishte kufizime substanciale veçanërisht në luftat që përfshinin forca të shpërndara dhe popullatë civile konsiderohej se ishte e parakohshme për të përfunduar se operacioni ushtarak ajror në Kosovë nuk do t'i arrinte objektivat e tij politike. Fushata kishte nisur me kujdes dhe në mënyrë graduale, duke reflektuar kufizimet e brendshme të Aleancës dhe shqetësimet për përshkallëzim. Për rrjedhojë, efektet e saj nuk mund të vlerësoheshin në mënyrë të arsyeshme përmes krahasimeve me raste historike të karakterizuara nga rrethana dhe ritme strategjike të ndryshme. Në këtë kontekst, krahasimet e shpeshta në opinionin amerikan me Vietnamin rezultuan veçanërisht ç'orientuese. Sipas politikëbërësve amerikan në Vietnam, shumica e sulmeve ajrore ishin përqendruar në zona rurale dhe ekonomia e Vietnamit të Veriut kishte qenë relativisht e ndjeshme ndaj goditjeve të synuara kundër infrastrukturës dhe aseteve kritike të regjimit. Në të kundërt, ekonomia dhe sistemi politik i Serbisë ishin dukshëm më të ekspozuara ndaj një fushate ajrore të vazhdueshme dhe të fokusuar. Në të vërtetë, kishte tashmë indikacione se bombardimet e NATO-s kishin filluar të ndikonin në llogaritjet e elitave politike dhe të aktorëve kryesorë ekonomikë brenda regjimit, duke sugjeruar se presioni ishte duke dhënë rezultate. Për rrjedhojë, deklaratat e parakohshme për dështimin e fushatës ajrore rrezikonin të shndërroheshin në profeci vetëpërmbushëse. Duke minuar besimin në fuqinë ajrore përpara se efektet e saj të materializoheshin plotësisht, narrativa të tilla kishin potencialin ta orientonin politikën drejt një pushtimi tokësor si alternativa e vetme e mbetur. Një zhvendosje e tillë do të kishte përfaqësuar një vendim me peshë historike. Nga perspektiva e politikës së Shteteve të Bashkuara, nxitimi për të përqaftuar opsionin e forcave tokësore ishte i nxitur më shumë nga konsiderata optike dhe politike sesa nga domosdoshmëria strategjike rrezikonte të përjashtonte opsione që vazhdonin të mbeteshin të zbatueshme brenda kornizës së diplomacisë shtrënguese.<sup>36</sup>

<sup>35</sup> Hadri, Arbër. "The Kosovo Self-Defense Act of 1999: Policy Proposal and Strategic Context." *European Journal of Economics, Law and Social Sciences* 9, no. 1 (2025): 82–88. Qasur më 30 gusht 2025. <https://doi.org/10.2478/ejels-2025-0007>.

<sup>36</sup> Ibid.

Kritikët e Administratës Amerikane arritën një rezonancë të veçantë politike duke u përqendruar në mungesën e një plani të artikuluar publikisht për operacionet tokësore. Kjo linjë kritike nuk kërkonte domosdoshmërisht miratim të hapur për një pushtim tokësor, por krijonte përshtypjen se Administrata po refuzonte në tërësi edhe planifikimin e kujdesshëm të emergjencës. Në praktikë, megjithatë, dallimi ndërmjet planifikimit dhe angazhimit ishte thelbësor. Hartimi i një plani nuk i detyronte vendimmarrësit ta zbatonin atë; përkundrazi, ai shërbente si mjet analitik për të vlerësuar kostot, rreziqet dhe pasojat e mundshme të një veprimi të tillë. Në mënyrë ironike, një planifikim serioz për opsionin tokësor mund të kishte forcuar kujdesin strategjik, në vend që të nxiste entuziazëm politik, duke e bërë më të qartë shkallën e përshkallëzimit që do të sillte një angazhim i tillë. Në fakt, pak nga avokatët e vendosjes së forcave tokësore në Kosovë ishin përballur plotësisht me implikimet konkrete të dërgimit të trupave në një mjedis jo paqësor (jo-lejues). Një vendim i tillë do të kishte përfaqësuar angazhimin më të rëndësishëm ushtarak të ndërmarrë nga një president amerikan që nga viti 1965, kur Presidenti Lyndon B. Johnson autorizoi vendosjen në shkallë të gjerë të forcave luftarake në Vietnam. Kjo paralele historike trajtohej në aspektin akademik jo për shkak të ngjashmërisë së drejtpërdrejtë midis dy luftërave, por për shkak të dinamikës politike që shoqëroi procesin e përshkallëzimit. Në pranverën e vitit 1965, Johnson kishte mbikëqyrur një rrëshqitje graduale drejt luftës, duke shmangur një debat të hapur dhe transparent me Kongresin dhe publikun amerikan, edhe pasi kishte filluar fushata ajrore kundër Vietnamit të Veriut. Njësitë luftarake u futën fillimisht nën justifikimin se po mbronin bazat ajrore, duke maskuar natyrën reale të angazhimit. Pasojat afatgjata të këtij procesi tejzgjatja strategjike jashtë vendit dhe zhvendosjet ekonomike brenda vendit rezultuan të thella dhe të qëndrueshme.<sup>37</sup>

Ndërlidhja me këtë analogji nuk kishte për qëllim të shërbente si argument kundër vendosjes përfundimtare të forcave tokësore të NATO-s, por në vetvete pasqyronte sentimentin amerikan ndaj dërgimit të forcave amerikane në luftë gjetiu. Në të vërtetë, u pranua gjerësisht se trupat e NATO-s pothuajse me siguri do të ishin të pranishme në Kosovë më vonë në vitin 1999 si pjesë e një force për zbatimin e paqes. Pasi të vendoseshin, forca të tilla pritej të qëndronin për një periudhë të zgjatur, siç kishte ndodhur në Bosnjë pas Marrëveshjes së Dejtonit. Çështja vendimtare, megjithatë, kishte të bënte me mënyrën e

---

<sup>37</sup> Ibid.

hyrjes së tyre. Nëse trupat e NATO-s hynin në Kosovë me ftesë, në përputhje me një marrëveshje formale me autoritetet në Beograd, apo nëse do të hynin përmes pushtimit me forcë, do të formësonte në thelb natyrën, kohëzgjatjen dhe koston e misionit. Dallimi midis mjediseve lejuese dhe jo-lejuese nuk ishte thjesht semantik. Në praktikë, kishte pak terren të mesëm kuptimplotë. Nocioni i një vendosjeje të trupave ushtarake në një vend që nuk ishte as plotësisht lejues dhe as hapur armiqësor, pasqyronte një mendim dëshiror sesa realitet operativ. Sipas politikëbërësve amerikan, trupat ose ftoheshin, duke u përballur me rezistencë të kufizuar dhe viktima të pakta, ose u kërkoheshin të luftonin kundër armikut të organizuar. Sipas një skenari tolerant, forcat e NATO-s mund të prisnin në mënyrë të arsyeshme që operacionet e tyre të kufizoheshin kryesisht në Kosovë, me vendosje ndihmëse në Maqedoni, Shqipëri dhe potencialisht në Mal të Zi. Sipas SHBA-së, nivelet e viktimave kishte të ngjarë të ishin të njëjta me ato në Bosnjë, ku prania e një zgjidhjeje të negociuar uli ndjeshëm rrezikun e luftimeve të vazhdueshme.<sup>38</sup>

Në të kundërt, sipas qëndrimit amerikan, një ndërhyrje tokësore pa pëlqim do të kishte zgjeruar ndjeshëm objektivat ushtarake të operacionit. Një pushtim i Kosovës nuk do të kishte mundur të kufizohej në mënyrë të besueshme vetëm brenda territorit të saj. Sipas vlerësimit amerikan, forcat serbe me gjasë do të tërheqeshin dhe riorganizoheshin përtej kufijve të Kosovës, duke e detyruar NATO-n t'i ndiqte ato më thellë në Serbi dhe Mal të Zi. Në rrethana ekstreme kjo logjikë, sipas analizës amerikane të situatës, do të kishte mundur të çonte deri në operacione të drejtuara kundër vetë Beogradit. Si rrjedhojë, ajo që kishte nisur si një ndërhyrje për mbrojtjen e Kosovës do të kishte rrezikuar të evoluonte në një luftë të plotë kundër shtetit jugosllav, me të gjitha pasojat politike dhe ushtarake që një përshkallëzim i tillë do të sillte. Nga një këndvështrim ushtarak, nuk kishte dyshim se një pushtim i tillë do të kishte përfunduar me sukses operacional. Superioriteti dërrmues i NATO-s në fuqi njerëzore, teknologji dhe kapacitete logjistike nënkuptonte se forcat serbe nuk do të kishin qenë në gjendje të zbrapsnin, në afat të gjatë, një ofensivë tokësore të vendosur. Megjithatë, një fitore e tillë do të kishte ardhur me një kosto të konsiderueshme. Humbjet njerëzore do të kishin qenë të pashmangshme, potencialisht të rënda, dhe pasojat politike e ushtarake do të kishin imponuar barra të mëdha dhe afatgjata mbi Aleancën. Pas një pushtimi, NATO në praktikë do të kishte “zotëruar” përgjegjësinë

---

<sup>38</sup> Ibid.

për Jugosllavinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë, duke marrë përsipër detyrime që do t'i ngjanin atyre të fuqive Aleate në Gjermani dhe Japoni pas Luftës së Dytë Botërore. Sipas qëndrimit amerikan një angazhim i tillë do të kishte kërkuar jo vetëm pushtim dhe administrim territorial, por edhe garantimin e sigurisë afatgjatë përballë kërcënimeve kryengritëse, përfshirë rrezikun e terrorizmit një skenar që do të sillte ndër mend përvoja destabilizuese si Somalia ose Bejruti.<sup>39</sup>

Edhe pa një pushtim të drejtpërdrejtë, NATO tashmë kishte angazhuar një prani të zgjëruar në rajon. Megjithatë, kushtet në të cilat kjo prani u vendosën ndikuan në formë vendimtare në qëndrueshmërinë dhe legjitimitetin e saj. Sipas SHBA-së, hyrja në Kosovë si pjesë e një zgjidhjeje të negociuar ankoronte rolin e NATO-s në mbështetjen ndërkombëtare dhe pranimin e heshtur lokal, ndërsa hyrja si forcë pushtuese e kishte ekspozuar Aleancën ndaj rezistencës dhe pakënaqësisë, duke rritur rreziqet e zvarritjes së misionit dhe reagimeve politike si në nivel lokal, ashtu edhe brenda shteteve anëtare. Qëndrimi amerikan konsideronte se fuqia ajrore ofronte një mjet për të ushtruar presion të qëndrueshëm, duke ruajtur kohezionin e Aleancës dhe duke kufizuar viktimat, por kërkonte durim dhe disiplinë strategjike. Në këtë kontekst cilësohej se pushtimi tokësor premtonte vendosmëri, por rrezikonte ta shndërronte një fushatë shtrënguese në një luftë të gjërë pushtuese me pasoja të gjera. Duke e paraqitur zgjedhjen në mënyrë të qartë, politikëbërësit amerikan u përballën me atë që shpesh u dramatizua si një vendim midis “Dejtonit” dhe “Ditës-D”. Opsioni i parë simbolizonte hyrjen e negociuar, objektivat e kufizuara dhe rrezikun e menaxhuar; opsioni i dytë evokonte pushtimin, angazhimin total dhe përgjegjësinë e pafundme.<sup>40</sup>

Në këtë kuptim, polemika mbi trupat tokësore nuk kishte të bënte vetëm me zgjedhjet taktike ushtarake. Ajo lidhej me natyrën e ndërhyrjes perëndimore në fund të shekullit të njëzetë, me kufijtë e asaj që një Aleancë mund të bënte në luftë dhe me pragjet politike që ndanin diplomacinë shtrënguese nga përfshirja në një luftë në shkallë të plotë. Në këtë kontekst, ngurrimi për të përqaftuar një politikë të pushtimit tokësor nuk pasqyronte pavendosmëri, por një vetëdije të thellë për historinë, për kostot e mundshme dhe për pasojat e paparashikuara. Suksesi i mundshëm i këtij qëndrimi varej më pak nga teoritë abstrakte mbi fuqinë ajrore sesa nga ndërveprimi në zhvillim midis presionit

---

<sup>39</sup> Ibid.

<sup>40</sup> Ibid.

ushtarak, dinamikës politike serbe përfshirë shenja dorëzimi dhe rezistence dhe vendosmërisë së Aleancës për të menaxhuar misionin me kujdes.

### **Përmbledhje: Korniza e politikave**

Gjatë luftës së Kosovës, politika e Shteteve të Bashkuara dhe Aleatëve të saj në NATO u bazua në një strategji diplomatike shtrënguese, e cila synonte të detyronte ndryshimin e sjelljes në Beograd, të ruante unitetin e Aleancës dhe të menaxhonte pasojat më të gjera të ndërhyrjes ushtarake në Evropën e pas Luftës së Ftohtë. Në thelb, kjo strategji u frymëzua nga njohja se sundimi i vazhdueshëm i Millosheviqit përbënte pengesën kryesore për stabilizimin rajonal. Ndryshimi i regjimit nuk u konsiderua objektiv i hapur, por një kusht strukturor për një zgjidhje të qëndrueshme. Angazhimi diplomatik nuk u konceptua si alternativë e pakushtëzuar ndaj forcës, por si një vazhdim i presionit ushtarak, ku çdo negociatë e besueshme varej nga margjinalizimi ose largimi efektiv i Millosheviqit.

Kur shfaqeshin mundësi për negociata para ndryshimit të regjimit, bisedimet zhvilloheshin me bashkëbisedues alternativë dhe jashtë territorit jugosllav, duke mohuar legjitimitetin politik të udhëheqësit serb, por duke ruajtur kanalet për të arritur pajtueshmëri mbi kërkesat thelbësore të NATO-s. Kur Beogradi dështoi të përmbushte pritshmëritë negociuese, politika amerikane theksoi intensifikimin e presionit, duke përdorur fuqinë ajrore si instrument të kalibruar për të ndryshuar llogaritjet kosto-përfitim të udhëheqjes serbe. Operacionet ushtarake zhvilloheshin njëkohësisht me çdo proces diplomatik, duke reflektuar mësimet nga luftërat në ish-Jugosllavi ku pauzat e presionit ushtarak kishin lejuar Beogradin të shfrytëzonte negociatat ndërkohë që vazhdonte dhuna në terren.

Kjo qasje gjithashtu reflektoi tensionin qendror midis përshkallëzimit shtrëngues dhe përmbajtjes politike: fuqia ajrore ruante kohezionin e Aleancës dhe kufizonte viktimat, ndërsa pushtimi tokësor premtonte vendosmëri, por rrezikonte të shndërrohej në një luftë të plotë me pasoja të gjera. Strategjia diplomatike dhe ushtarake synonte kështu të menaxhonte ndërveprimin kompleks midis presionit ushtarak, dinamikës politike serbe dhe vendosmërisë së Aleancës për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme pa përshkallëzim total.<sup>41</sup>

<sup>41</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 7-8, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

Gjatë gjithë luftës, zyrtarët amerikanë mbetën të pavullneshëm për të bërë kompromis mbi një sërë objektivash të panegociueshme. Këto përfshinin ndërprerjen e dhunës, tërheqjen e forcave ushtarake dhe të sigurisë serbe nga Kosova, si dhe vendosjen e një pranie ndërkombëtare të fuqishme, e aftë të garantonte sigurinë dhe të lehtësonte shpërndarjen e ndihmës humanitare. Njëkohësisht, u pranua se disa çështje politike, veçanërisht statusi përfundimtar i Kosovës, mund të shtyheshin në mënyrë strategjike për të lehtësuar arritjen e pajtueshmërisë dhe stabilizimin e menjëhershëm. Kjo hierarki reflektonte një vlerësim pragmatik se përparimi i parakohshëm mbi sovranitetin dhe çështjet politike të ndjeshme mund të copëtonte kohezionin e Aleancës dhe të pengonte përfundimin e luftës.<sup>42</sup>

Paralelisht me këto llogaritje diplomatike dhe ushtarake, politika amerikane u përball edhe me çështjen e pazgjidhur të ndërhyrjes tokësore. Ndërsa NATO nuk nisi një pushtim tokësor gjatë luftës, u zhvillua një planifikim serioz për një opsion të tillë. Politikëbërësit kuptuan se një operacion tokësor do të përfaqësonte një përshkallëzim cilësor, me implikime të thella ushtarake dhe politike, duke përfshirë mundësinë e një angazhimi afatgjatë pa një strategji të qartë daljeje. Megjithatë, vetë procesi i planifikimit konsiderohej strategjikisht i vlefshëm. Përgatitjet e dukshme, të orientuara si ndaj audiencës vendase ashtu edhe ndërkombëtare, synonin të rrisnin ndikimin shtrëngues mbi Beogradin, duke përforcuar ndërkohë ndërgjegjësimin publik mbi rreziqet dhe kostot e natyrshme të një përshkallëzimi të mëtejshëm.<sup>43</sup>

Konsideratat humanitare morën një rol gjithnjë e më qendror në planifikimin pas luftës. Në fazat e vona të luftës, katastrofa humanitare në Kosovë tejkaloi çdo krizë të krahasueshme në Evropë që nga viti 1945. Vlerësimet e SHBA-së dhe Aleatëve parashikuan se shkalla e shkatërrimit, zhvendosjes dhe kolapsit shoqëror do të kërkonte një angazhim ndërkombëtar të qëndrueshëm, i cili shtrihej përtej ndërprerjes së armiqësive. Dimensioni humanitar nuk u trajtua si një shqetësim ndihmës, por si komponent integral i strategjisë së përgjithshme, duke influencuar objektivat ushtarake dhe strukturat institucionale të pasluftës. Politikëbërësit amerikanë filluan të planifikonin krijimin e një kujdestarie ose protektorati ndërkombëtar, si mekanizëm kalimtar i bazuar në legjitimitet shumëpalësh dhe i miratuar nga Grupi i Kontaktit. Synimi ishte të largonte përkohësisht Kosovën nga

---

<sup>42</sup> Ibid.

<sup>43</sup> Ibid.

kontrolli politik i Beogradit pa vendosur menjëherë statusin përfundimtar, duke u fokusuar tek marrëveshja mbi parimet e administrimit ndërkombëtar dhe duke shtyrë debatet mbi qeverisjen dhe sovranitetin. Kjo qasje reflektoi vetëdijen për rreziqet e një vakumi pushteti dhe nevojën për përkrahjen shumëdimensionale humanitare për popullatën shqiptare, pas spastrimit etnik të Kosovës të orkestruar nga shteti serb.<sup>44</sup>

Përtej elementëve qendrorë të strategjisë, politika e SHBA-së trajtoi një sërë shqetësimesh të tjera strategjike. Presioni ekonomik mbi Jugosllavinë u intensifikua përmes sanksioneve dhe kufizimeve financiare, të hartuara për të dobësuar aftësinë e regjimit për të mbështetur operacionet ushtarake dhe represionin e brendshëm. Njëkohësisht, u vu theks i veçantë mbi komunikimin strategjik drejt publikut serb. Zyrtarët amerikanë identifikuan fushën informative si një arenë kritike të kontestimit, duke synuar të kundërshtonin propagandën e regjimit dhe të ekspozonin realitetin e operacioneve serbe në Kosovë, me qëllim dobësimin e mbështetjes së brendshme për Millosheviqin dhe nxitjen e ndryshimit të sjelljes së udhëheqjes politike.<sup>45</sup>

Trajtimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) u identifikua gjithashtu si një sfidë e rëndësishme politike. Ndërsa UÇK-ja kishte fituar statusin e një aktori të domosdoshëm në terren, ajo nuk përshtatej në mënyrë të plotë brenda kuadrit strategjik të NATO-s. Politikëbërësit amerikanë kuptuan se neglizhimi i saj do të rrezikonte stabilizimin pas luftës. Si pasojë, u vendos për një qasje të dallueshme politike që kombinonte angazhimin me mbikëqyrjen dhe demilitarizimin, të integruara brenda një kuadri më të gjerë institucional, i cili synonte të siguronte stabilitetin dhe legjitimitetin e procesit pasluftës.<sup>46</sup>

Së fundmi, çështja e drejtësisë fitoi një rëndësi gjithnjë e më të madhe ndërsa lufta përparonte drejt përfundimit. Shkalla e gjenocidit dhe mizorive të kryera në Kosovë gjeneroi kërkesa të forta për llogaridhënie, veçanërisht nga shqiptarët e Kosovës, për të cilët drejtësia ishte e pandashme nga përvoja e krimeve kundër njerëzimit dhe spastrimit etnik. Për pasojë, politika e SHBA-së i kushtoi një vëmendje të veçantë punës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, duke marë paraasysh se çdo rezultat i negociuar që

---

<sup>44</sup> *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, p. 7-8, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, National Archives and Records Administration (NARA), Little Rock, AR, USA.

<sup>45</sup> *Ibid.*

<sup>46</sup> *Ibid.*

përfshinte Millosheviqin do të përbënte objekt kritikash të konsiderueshme. Duke parashikuar mjedisin pas luftës, Shtetet e Bashkuara konsideronin se kërkesat për ndjekje penale dhe llogaridhënie do të shtoheshin, në vend që të zbehen, dhe se drejtësia do të përbënte një shtyllë qendrore të legjitimitetit të procesit pas luftës në Kosovë.<sup>47</sup>

Dorëzimi i Millosheviqit rezultoi nga një konvergjençë e faktorëve të ndërlikur, si të jashtëm ashtu edhe të brendshëm. Katalizatori kryesor ishte zbatimi intensiv dhe i vazhdueshëm i fuqisë ajrore të NATO-s gjatë fushatës së bombardimeve shtatëdhjetë e tetë ditore, i cili demonstroi aftësinë e Aleancës për të mbajtur operacionet për një periudhë të pacaktuar pa kosto të konsiderueshme. Presionin ushtarak e përforcoi izolimi ndërkombëtar në rritje i Millosheviqit, veçanërisht pas tërheqjes së mbështetjes nga Rusia si reagim ndaj mizorive të dokumentuara në Kosovë. Ky izolim u intensifikua nga aktakuza e tij nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, e lëshuar vetëm një javë pas humbjes së mbështetjes ruse. Presionet e brendshme luajtën gjithashtu një rol vendimtar. Sulmet e gjera të NATO-s në Beograd dhe zonat përreth, që synuan objektet ushtarako-industriale, infrastrukturën dhe shërbimet thelbësore, shkaktuan një krizë ekonomike, politike dhe psikologjike, duke minuar legjitimitetin e brendshëm të Millosheviqit dhe duke dobësuar mbështetjen për regjimin, veçanërisht në kryeqytet. Perspektiva e një ndërhyrjeje tokësore të NATO-s, gjithnjë e më e perceptuar si e pashmangshme deri në fund të majit, e rriti presionin mbi regjimin. Ky kombinim i bombardimeve, izolimit ndërkombëtar dhe destabilizimit të brendshëm krijoi kushtet në të cilat Millosheviqi nuk kishte alternativë tjetër përveç kapitullimit. Dorëzimi i tij nënkuptoi tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, duke ruajtur përkohësisht kontrollin e tij brenda Serbisë, por dobësoi autoritetin e tij dhe krijoi mundësi për transformime të mëvonshme politike. Dorëzimi i Millosheviqit mund të kuptohet kështu jo si një akt vullnetar pajtimi, por si produkt i presioneve të koordinuara ushtarake, diplomatike dhe të brendshme që e bënë rezistencën të papërballueshme.<sup>48</sup>

Diplomacia amerikane luajti një rol vendimtar në negociatat që kulmuan me Marrëveshjen Ushtarako-Teknike të Kumanovës më 9 qershor 1999, dokument që në praktikë i dha fund luftës dhe mundësoi vendosjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë. SHBA-të mbështetën fuqimisht këmbënguljen për

<sup>47</sup> Ibid.

<sup>48</sup> Benjamin S. Lambeth, *NATO's Air War for Kosovo: A Strategic and Operational Assessment* (Pittsburgh: RAND, 2001), xiii-xxiv.

të siguruar tërheqjen e plotë të forcave ushtarake dhe të sigurisë serbe nga territori, si dhe për të garantuar që prania ndërkombëtare të ishte mjaftueshëm e fuqishme dhe e udhëhequr nga NATO për të siguruar stabilitetin dhe sigurinë në një mjedis pasluftës. Politika e SHBA-së konsideronte se përzënia e forcave serbe nga Kosova dhe vendosja e një kuadri ndërkombëtar sigurie nuk përbënin vetëm një masë teknike, por ishte parakusht i domosdoshëm për kthimin e refugjatëve, rivendosjen e shërbimeve humanitare dhe konsolidimin e stabilitetit rajonal afatgjatë. Kjo qasje theksoi rëndësinë e koordinimit midis presionit ushtarak, legjitimitetit ndërkombëtar dhe instrumenteve humanitare, duke ilustruar se suksesi në fazën pas luftës varej nga integrimi i elementëve politiko-ushtarak dhe humanitar, në një strategji të vetme dhe të qëndrueshme.

Në përmbledhje, këto dinamika pasqyruan natyrën thelbësisht të integruar të politikës amerikane gjatë luftës në Kosovë. Presioni ushtarak, angazhimi diplomatik, ndërhyrja humanitare dhe organizimi i qeverisjes pas luftës nuk funksionuan si instrumente të ndara, por si komponentë të ndërlidhur që përforconin reciprokisht një strategji gjithëpërfshirëse. Efektiviteti i kësaj qasjeje varej në masë të madhe nga vazhdimësia e presionit, koordinimi i kujdesshëm institucional dhe gatishmëria për të marrë mbi vete përgjegjësinë afatgjatë për pasojat politike, humanitare dhe administrative të ndërhyrjes. Në këtë kuptim, lufta e Kosovës nuk u trajtua thjesht si një sfidë rajonale, por si një test vendimtar i diplomacisë shtrënguese dhe i kapacitetit të rendit ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, duke ofruar mësim të rëndësishme për mënyrën se si kombinimi i forcës, diplomacisë dhe ndihmës ndërkombëtare mund të prodhojë stabilitet afatgjatë në një kontekst pas luftës.<sup>49</sup>

### **Summary: Policy Framework**

The policy framework pursued by the United States and NATO during the Kosovo war was grounded in a coercive diplomatic strategy aimed at compelling behavioral change in Belgrade, preserving Alliance cohesion, and managing the broader systemic consequences of military intervention in post-Cold War Europe. Central to this approach was the recognition that Slobodan Milošević's continued rule constituted the principal obstacle to conflict resolution and regional stabilization. Accordingly, U.S. policy consistently

---

<sup>49</sup> Hadri, Arbër. "The Kumanovo agreement: Establishing the conditions for Kosovo's governance." *Academic Journal of Business* 11, no. 1 (2025).

treated regime change not as an explicit objective, but as a structurally necessary condition for a sustainable settlement as the most desirable outcome. Diplomatic engagement was thus conceived not as an alternative to force, but as an extension of military pressure. Any credible negotiating process required either Milošević's removal or his effective marginalization. When talks occurred prior to regime change, they were held outside Yugoslav territory and with interlocutors other than Milošević to deny him political legitimacy while preserving channels capable of achieving NATO's core demands. Where Belgrade failed to advance a credible position, U.S. policy emphasized intensifying, rather than suspending, coercive pressure. Sustained air strikes were designed to alter the cost-benefit calculations of the Serbian leadership, reflecting lessons from earlier Balkan crises in which pauses in military pressure allowed Belgrade to exploit diplomacy while continuing operations on the ground.

Throughout the war, U.S. officials remained unwilling to compromise on non-negotiable objectives: cessation of violence, withdrawal of Serbian forces from Kosovo, and establishment of a robust international presence capable of ensuring security and humanitarian relief. Certain political questions most notably Kosovo's final status were deferred to maintain Alliance cohesion and facilitate immediate stabilization. Parallel to these considerations, serious planning for a potential NATO ground intervention was undertaken. While a ground invasion was not launched, its preparation served as a strategic lever, signaling the risks and costs of escalation to both domestic and international audiences.

Humanitarian considerations became central to post-conflict planning. By the late stages of the war, the humanitarian catastrophe in Kosovo surpassed any European crisis since 1945. U.S. and allied assessments anticipated that recovery would require sustained international engagement beyond the cessation of hostilities. Policymakers therefore planned for an international trusteeship or protectorate, endorsed by the Contact Group, to temporarily remove Kosovo from Belgrade's control without immediately resolving its final status. The focus was on agreement over international administration principles while postponing contentious debates over governance and sovereignty, reflecting an acute awareness of the risks posed by a post-war power vacuum and the need to secure displaced populations.

Additional strategic concerns included intensifying economic pressure through sanctions, leveraging strategic communications to undermine regime

propaganda, and managing the Kosovo Liberation Army (KLA). While the KLA was indispensable on the ground, uncritical support risked undermining international norms and complicating post-war governance, prompting calls for engagement, oversight, and demilitarization within a broader institutional framework. Justice also assumed growing importance. The scale of atrocities and genocide committed by the Serbian regime against the Albanian population in Kosovo generated strong demands for accountability, particularly among Kosovar Albanians, rendering support for the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia a central pillar of post-conflict legitimacy.

Milošević's surrender resulted from interrelated external and domestic pressures. Sustained NATO air power during the seventy-eight-day bombing campaign, growing international isolation, the ICC indictment, and extensive domestic destabilization including economic, political, and psychological crises left him with little choice. The looming prospect of a NATO ground intervention intensified pressure, culminating in his capitulation, which entailed withdrawal of Serbian forces from Kosovo while temporarily preserving his control in Serbia, though significantly weakening his authority.

U.S. diplomacy played a central role in negotiations leading to the Kumanovo Military-Technical Agreement of 9 June 1999, ending the war and enabling deployment of international forces. Washington insisted on full Serbian withdrawal and a NATO-led international presence, prerequisites for refugee return, humanitarian recovery, and long-term regional stability.

In sum, these dynamics illustrated the integrated nature of U.S. policy in Kosovo. Military coercion, diplomacy, humanitarian intervention, and post-conflict governance were mutually reinforcing components of a comprehensive strategy. Success depended on sustained pressure, institutional coordination, and readiness to accept long-term responsibility for the political and humanitarian consequences of intervention. Kosovo was thus not merely a regional crisis, but a defining test of post-Cold War coercive diplomacy and international order.

**Bibliografi:****Burimet arkivore:**

- *Kosovo Diplomatic Strategy*, memorandum, Department of State, March 27, 1999, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, NARA, Little Rock, AR, USA.
- *Kosovo Next Steps*, Richard Holbrooke, Memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, pp. 1–8, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, NARA, Little Rock, AR, USA.
- Richard Holbrooke, *Some Thoughts about Slobodan Milosevic*, memorandum to the Secretary of State and the National Security Advisor, April 20, 1999, National Security Council Records, Clinton Presidential Library, NARA, Little Rock, AR, USA.

**Literatura:**

- Arbër Hadri, *Politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes së Kosovës 1989–2008* (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri,” 2024), 45.
- Arbër Hadri, “Ultimatumi i Presidentit Bill Clinton dhe përgatitjet për intervenimin ushtarak në Kosovë: shtator–tetor 1998,” *Kosova*, no. 47 (2024): 149–170.
- Arbër Hadri, “The Kosovo Self-Defense Act of 1999: Policy Proposal and Strategic Context.” *European Journal of Economics, Law and Social Sciences* 9, no. 1 (2025): 82–88.
- Arbër Hadri, “The Kumanovo Agreement: Establishing the Conditions for Kosovo’s Governance,” *Academic Journal of Business* 11, no. 1 (2025).
- Benjamin S. Lambeth, *NATO’s Air War for Kosovo: A Strategic and Operational Assessment* (Pittsburgh: RAND, 2001), xiii–xxiv.

**Arbër HADRI**

The Institute of History “Ali Hadri”

Email: arberhadri@outlook.com

ORCID: 0009-0000-5235-2962

KUD: 327(73):355.4(496.51)“1999”(05)

**SUMMARY****U.S. DIPLOMACY IN THE KOSOVO AIR CAMPAIGN:  
STRATEGY, SECURITY, AND INTERNATIONAL  
RELATIONS**

The policy framework pursued by the United States and NATO during the Kosovo war was grounded in a coercive diplomatic strategy aimed at compelling behavioral change in Belgrade, preserving Alliance cohesion, and managing the broader systemic consequences of military intervention in post-Cold War Europe. Central to this approach was the recognition that Slobodan Milošević’s continued rule constituted the principal obstacle to conflict resolution and regional stabilization. Accordingly, U.S. policy consistently treated regime change not as an explicit objective, but as a structurally necessary condition for a sustainable settlement as the most desirable outcome. Diplomatic engagement was thus conceived not as an alternative to force, but as an extension of military pressure. Any credible negotiating process required either Milošević’s removal or his effective marginalization. When talks occurred prior to regime change, they were held outside Yugoslav territory and with interlocutors other than Milošević to deny him political legitimacy while preserving channels capable of achieving NATO’s core demands. Where Belgrade failed to advance a credible position, U.S. policy emphasized intensifying, rather than suspending, coercive pressure. Sustained air strikes were designed to alter the cost-benefit calculations of the Serbian leadership, reflecting lessons from earlier Balkan crises in which pauses in military pressure allowed Belgrade to exploit diplomacy while continuing operations on the ground.

Throughout the conflict, U.S. officials remained unwilling to compromise on non-negotiable objectives: cessation of violence, withdrawal of Serbian forces from Kosovo, and establishment of a robust international presence capable of ensuring security and humanitarian relief. Certain political questions most notably Kosovo’s final status were deferred to maintain Alliance cohesion and facilitate immediate stabilization. Parallel to these considerations, serious planning for a potential NATO ground intervention was undertaken. While a ground invasion was not launched, its preparation served as a strategic lever, signaling the risks and costs of escalation to both domestic and international audiences.

Humanitarian considerations became central to post-conflict planning. By the late stages of the war, the humanitarian catastrophe in Kosovo surpassed any European crisis since 1945. U.S. and allied assessments anticipated that recovery would require sustained international engagement beyond the cessation of hostilities. Policymakers therefore planned for an international trusteeship or protectorate, endorsed by the Contact Group, to temporarily remove Kosovo from Belgrade's control without immediately resolving its final status. The focus was on agreement over international administration principles while postponing contentious debates over governance and sovereignty, reflecting an acute awareness of the risks posed by a post-war power vacuum and the need to secure displaced populations.

Additional strategic concerns included intensifying economic pressure through sanctions, leveraging strategic communications to undermine regime propaganda, and managing the Kosovo Liberation Army (KLA). While the KLA was indispensable on the ground, uncritical support risked undermining international norms and complicating post-war governance, prompting calls for engagement, oversight, and demilitarization within a broader institutional framework. Justice also assumed growing importance. The scale of atrocities generated demands for accountability, particularly among Kosovar Albanians, making support for the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia central to post-conflict legitimacy.

Milošević's surrender resulted from interrelated external and domestic pressures. Sustained NATO air power during the seventy-eight-day bombing campaign, growing international isolation, the ICC indictment, and extensive domestic destabilization including economic, political, and psychological crises left him with little choice. The looming prospect of a NATO ground intervention intensified pressure, culminating in his capitulation, which entailed withdrawal of Serbian forces from Kosovo while temporarily preserving his control in Serbia, though significantly weakening his authority.

U.S. diplomacy played a central role in negotiations leading to the Kumanovo Military-Technical Agreement of 9 June 1999, ending the war and enabling deployment of international forces. Washington insisted on full Serbian withdrawal and a NATO-led international presence, prerequisites for refugee return, humanitarian recovery, and long-term regional stability.

In sum, these dynamics illustrated the integrated nature of U.S. policy in Kosovo. Military coercion, diplomacy, humanitarian intervention, and post-conflict governance were mutually reinforcing components of a comprehensive strategy. Success depended on sustained pressure, institutional coordination, and readiness to accept long-term responsibility for the political and humanitarian consequences of intervention. Kosovo was thus not merely a regional crisis, but a defining test of post-Cold War coercive diplomacy and international order.